



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIT

Nr. 153 Akti

**Nr. 222 Vendimi
Tiranë, më 12.12.2019**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në datën 11.12.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Marjana Velçani**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

“**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Velçani, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.5.2018, të trupit gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisionere Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

4. Në datën 19.12.2018 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, si dhe u informua nga Komisioni se sipas vendimit nr. 40, datë 16.7.2018, komisionerja Firdes Shuli kishte zëvendësuar komisionere Alma Faskaj. Në datën 21.12.2018 subjekti i rivlerësimit deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 11.11.2019, Komisioni, me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Mariana Velçani, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht që të paraqesë pretendimet e saj brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 12.11.2019, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit dhe në datën 14.11.2019, dërgoi me *e-mail*, si dhe në rrugë zyrtare kërkesën me nr. *** prot., datë 13.11.2019, me të cilën kërkonte që për të saktësuar momentin se kur është bërë realisht pagesa për pasurinë, *apartament në Berat*, të thirrej si dëshmitar, z. Ll. D., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “K***” sh.p.k., të pyetj në prezencë të subjektit, dhe për të saktësuar vlerën mbi arredimin e pasurisë së shtëpisë në Berat kërkoi të kryej verifikimi në vend nga Komisioni, duke vijuar në kërkesën e saj që ky verifikim të kryhej edhe për pasurinë apartamentin në Tiranë.

7. Komisioni, pasi trajtoi kërkesën e subjektit të paraqitur në parashtrimet e saj dhe me vendimin e datës 21.11.2019, vendosi refuzimin për shkak se nga hyrja në historikun e kësaj shoqërie, në sistemin *on-line* të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, nuk identifikohet në vitin 2002-2003, si administrator i shoqërisë z. Ll. D. dhe në kushtet kur nuk u vërejt ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë midis subjektit të rivlerësimit dhe z. Ll. D. apo edhe midis shoqërisë dhe këtij të fundit, nuk çmoi të nevojshëm thirrjen e tij në cilësinë e dëshmitarit. Ndërsa, në lidhje me këqyrjen e shpenzimeve të arredimit të pasurisë në qytetin e Beratit dhe të Tiranës, Komisioni refuzoi kërkesën për shkak se vetë subjekti kishte deklaruar arredimin e shtëpisë me adresë në qytetin e Beratit, në vitet 2002 - 2006 dhe duke u nisur nga periudha e largët e arredimit ka çmuar se këqyrja në vend e shpenzimeve të kryera nuk do t’i shërbente

vërtetësisë dhe saktësisë së fakteve të konstatuara dhe për pasojë u vlerësua e panevojshme. Ndërsa, lidhur me këqyrjen e shpenzimeve për arredimin e shtëpisë në qytetin e Tiranës, Komisioni ka çmuar të panevojshme ndjekjen e kësaj procedure për shkak se në rezultatet e hetimit administrativ nuk është parashtruar asnjë fakt apo kontestim mbi arredimin e kësaj pasurie. Komisioni i njoftoi subjektin të rivlerësimit po në datën 21.11.2019, në mënyrë elektronike dhe zyrtare, vendimin e ndërmjetëm.

8. Në datën 6.12.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 11.12.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Në datën 11.12.2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Mariana Velçani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Subjekti, në përfundim të parashtrimeve, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Mariana Velçani. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 11.12.2019, për të rifilluar në datën 12.12.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Mariana Velçani ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSI I PASURISË

1. Në lidhje me apartamentin me sip. 111 m², ndodhur lagjen “**”, Berat, krijuar datë 16.4.2003, sipas kontratës datë 9.4.2003, në vlerën 3.000.000 lekë, i rivlerësuar në nëntor të vitit 2011, sipas ligjit nr. 10418/2011, në vlerën 6.300.000 lekë, paguar 33.000 lekë (1% e**

vlerës së shtuar). Burim i deklaruar krijimi: vlera 20.000 euro, kredi në “Alpha Bank”, dega Berat, sipas kontratës së datës 27.6.2003; vlera 300.000 lekë të ardhura nga paga.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹.

ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: konstatohet se apartamenti është blerë sipas kontratës datë 9.4.2003, e cila lidhur me vlerën dhe mënyrën e pagesës citon se është bërë likuidimi i plotë i shumës prej 3.000.000 lekësh jashtë zyrës noteriale. Referuar kontratës së kredisë bankare dhe vërtetimit lëshuar nga “Alpha Bank” rezulton se kredia në vlerën 20.000 euro është marrë në datën 2.7.2003, rreth tre muaj më vonë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri: në vitin 2003, me përshkrim, *apartament 2+1, me sip. 110 m², në vlerën 3.000.000 lekë, me kredi në “Alpha Bank”, si dhe kursime në vite*; në vitin 2004, me përshkrim, *shtëpi banimi, në vlerën 3.000.000 lekë, 50 %, ndërsa në rubrikën “data dhe viti i krijimit të pasurisë” ka deklaruar datën 27.6.2004.*

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2018, drejtuar ZQRPP-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2019, ZVRPP-ja Berat ka dërguar informacion dhe dokumentacionin përkatës.

- Shkresë nr. *** prot., dërguar shoqërisë ndërtimore “K****” sh.p.k.

Shoqëria ndërtimore “K****” sh.p.k., me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2019, ka dërguar informacion përkatës.

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2018, drejtuar OSHEE-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2018, ky institucion konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë kontrata me OSHEE-në, ndërsa subjekti ka vënë në dispozicion librezën përkatëse për këtë pasuri, nga ku rezulton se kjo kontratë energjie ka titullar bashkëshortin e subjektit.

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2018, drejtuar UKT-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2019, UKT-ja nuk ka konfirmuar abonent me kontratë për këtë pasuri, ndërsa subjekti ka vënë në dispozicion librezën përkatëse për këtë pasuri, nga ku rezulton se kjo kontratë uji ka titullar bashkëshortin e subjektit.

- Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2018, drejtuar Bankës së Shqipërisë dhe të gjitha bankave të nivelit të dytë, si dhe institucioneve jobankare.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2018, “Alpha Bank” ka konfirmuar se vë në dispozicion informacionin që i korrespondon periudhës prej datës 2.3.2009 dhe në vijim.

Analiza e provave dhe fakteve

- Nga aktet e administruara në dosjen e hetimit administrativ, rezulton se ZVRPP-ja konfirmon pasurinë me të njëjtën sipërfaqe të deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, të llojit apartament me sip. 111 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në z.k****, Berat, përfituar sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 9.4.2003.

- Sipas kartelës së kësaj pasurie rezulton se pasuria është regjistruar në datën 29.4.2003 dhe se vlera e paguar është 3.000.000 lekë.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ky institucion rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.V., me kontratën e lartpërmendur ka blerë nga firma “K****”

¹ Vërtetim hipotekor; kontratë shitje pasurie, nr. ***, datë 9.4.2003; vërtetim datë 31.10.2016, nga “Alpha Bank”; kontratë kredie nr. ***, datë 27.6.2003; raport vlerësimi për apartamentin, në dosjen e ILDKPKI-së.

sh.p.k., në datën 9.4.2003, pasurinë e përshkruar me të njëjtat të dhëna të deklaruara nga subjekti dhe të konfirmuara edhe nga ZVRPP-ja Berat.

- Sipas kontratës së shitjes së kësaj pasurie, rezulton se me nënshkrimin e saj pasuria është marrë në dorëzim nga blerësi dhe e gjithë shuma prej 3.000.000 lekësh (deklaruar në kontratë nga përfaqësuesi i shitësit) është marrë tërësisht në dorëzim jashtë zyrës noteriale.

- Shoqëria ndërtimore “K***” sh.p.k., ka informuar se shtetasi A. V. në muajin mars 2002 ka porositur një apartament në lagjen “***”, Berat, në z.k. ***. Çmimi i këtij apartamenti ishte 24.000 USD që për kursin e kohës përkonte me vlerën 3.000.000 lekë. Shoqëria ndërtimore ka bërë me dije se vlera e apartamentit është paguar tërësisht me këste, sipas mandatarkëtimeve që ka depozituar.

- Nga mandatarkëtimet rezulton se bashkëshorti i subjektit, z. A. V., ka paguar:

me mandatarkëtimin nr. ***, datë 20.3.2002, vlerën 500 USD;
me mandatarkëtimin nr. ***, datë 27.8.2002, vlerën 1.000 USD;
me mandatarkëtimin nr.***, datë 8.11.2002, vlerën 1.000 USD;
me mandatarkëtimin nr. ***, datë 1. 7.2003, vlerën 6.610 USD;
me mandatarkëtimin nr. ***, datë 3. 7.2003, vlerën 6.890 USD;
me mandatarkëtimin nr. ***, datë 4. 7.2003, vlerën 4.000 USD;
me mandatarkëtimin nr. ***, datë 5.7.2003, vlerën 4.000 USD.

- Kontrata e shitjes, si akt i cili ka fuqi ligjore dhe shtrin efektet prej nënshkrimit të saj, rezulton të jetë hartuar dhe nënshkruar konform parashikimeve të bëra në Kodin Civil. Në të janë parashikuar palët kontraktore, është përcaktuar objekti - shitblerje pasurie, është përcaktuar shuma për blerjen e pasurisë, si dhe është përcaktuar se me nënshkrimin e saj njëra nga palët zhvishet nga pronësia dhe tjetra bëhet pronar i pasurisë. Në kontratë nuk ka të parashikuar kushte të cilat të mund të kufizonin regjistrimin e kësaj pasurie. Në mbështetje të kësaj kontrate, vetëm disa ditë pas nënshkrimit të saj, është bërë edhe regjistrimi i kësaj pasurie. Subjekti është pyetur² nëse ka pasur paraprakisht një kontratë porosie apo sipërmarrjeje për këtë pasuri, për të cilën ka deklaruar se nuk ka ekzistuar një e tillë.

- Në ndryshim nga kryerja e të gjithë veprimeve ligjore, shoqëria ndërtimore megjithëse ka pranuar në kontratë marrjen në dorëzim të të gjithë shumës që në nënshkrimin e saj, si dhe ka pranuar edhe regjistrimin e saj, ka depozituar shtatë mandate, nga të cilat katër datojnë pas momentit të regjistrimit të pasurisë në ZVRPP.

- Mandatet e depozituara pasqyrojnë shuma të paguara në monedhën USD, ndërsa kontrata e shitjes pasqyron vlerën në monedhën lekë.

- Në ndryshim nga sa më sipër, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, kredinë e përfituar në monedhën euro, në “Alpha Bank” në vlerën 20.000 euro, si dhe 300.000 lekë të ardhura nga pagat.

- Në lidhje me kredinë e përfituar në “Alpha Bank”, rezulton se është nënshkruar kontrata e kredisë³ me nr. ***, datë 27.6.2003, me “Alpha Bank”, sipas të cilës subjekti i rivlerësimit ka përfituar vlerën 20.000 euro.

- Në kontratë nuk rezulton të jetë vendosur *kolateral* për përfitimin e saj.

- Kontrata nuk ka parashikuar qëllimin e përfitimit të kësaj vlere.

- Me vërtetimin nr. ***, datë 31.10.2016, “Alpha Bank” konfirmon disbursimin e kredisë në vlerën 20.000 euro në datën 2.7.2003 të shlyer totalisht më 9.7.2009. Interesi i paguar për këtë

² Me e-mail, datë 10.10.2019, në dosjen e Komisionit.

³ Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

kredi gjatë kësaj periudhe ka qenë në vlerën 3.970,35 euro. Pra, në total shuma e paguar për këtë kredi është 23.970,35 euro.

- Komisioni ka konstatuar se kjo kredi është përfituar rreth tre muaj pas nënshkrimit të kontratës së shitjes së kësaj pasurie, është pranuar në kontratë se është shlyer e gjithë shuma 3.000.000 lekë, si dhe është regjistruar në ZVRPP-në Berat.

- Kontrata është parashikuar në monedhën lekë, ndërsa shoqëria ndërtimore e ka barasvlerësuar në informacionin e saj monedhën *lekë* me monedhën *dollar*, ndërsa kredia është përfituar në *euro*.

- Nuk rezulton që kredia të ketë kaluar me transaksion bankar në favor të shoqërisë ndërtimore.

- Sipas mandateve rezulton se përpara disbursimit të kredisë janë shlyer katër këste pagesash, sipas mandateve përkatëse, përkatësisht në datën 20 mars 2002, në vlerën 500 USD, në datën 27 korrik 2002 dhe 8 nëntor 2002 në vlerat respektive nga 1.000 USD dhe në datën 1 korrik 2003 në vlerën 6.610 USD, ndërsa pas datës së disbursimit të kredisë janë shlyer tri këste pagesash, sipas mandateve përkatëse, përkatësisht në datë 3, 4 dhe 5 korrik 2003 në vlerën 6.890 USD dhe në dy datat e fundit me vlerë me nga 4.000 USD.

- Subjekti është pyetur⁴ në lidhje me mospërputhjet midis shlyerjeve të pagesave, nënshkrimit të kontratës së shitjes, si dhe disbursimit të kredisë dhe në përgjigjen e dhënë ka shpjeguar se: *“Shtëpia që kemi në Berat, në lagjen “***” është hipotekuar në prill të vitit 2003, me qëllimin e vetëm që të sigurohej mjeti i sigurimit (kolateral) për kredinë e marrë në fund të qershorit të vitit 2003, në ‘Alpha Bank’, Berat. Kjo është bërë në mirëbesim me shoqërinë “K***” sh.p.k., si e vetmja mënyrë që banka të garantonte dhënien e kredisë. Po kjo shtëpi e hipotekuar është bllokuar për llogari të bankës në datën 27.6.2003, me miratimin e kredisë dhe se gjithë shuma e kredisë është përdorur për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “K***” sh.p.k. Mandatarkëtimi i lëshuar nga shoqëria përfituese “K***” sh.p.k., datë 1.7.2003 me shumën 6.610 USD, ka të bëjë me kontabilitetin e shoqërisë. Pas marrjes së kredisë gjithë shuma e konvertuar nga euro/USD, kaloi në favor të shoqërisë “K***” sh.p.k. Theksojmë se shuma është tërhequr në euro dhe shoqërisë i janë dhënë në USD. Gjithë veprimi i këmbimit të valutave është bërë jashtë bankës për arsye se tregu afrente kurs më të mirë këmbimi”.*

Subjekti ka depozituar:

- kontratë hipoteke nr. ***, datë 27.6.2003, të nënshkruar me bankën, si dhe deklaratë noteriale të datës 27.6.2003;
- marrëveshje shtesë financimi në datën 26 mars 2003;
- vërtetim hipoteke nga ZVRPP-ja Berat, lëshuar në datën 15.5.2003;
- hartën treguese të regjistrimit të pasurisë;
- vërtetim për bllokim pasurie, datë 1.7.2003, lëshuar nga ZVRPP-ja Berat;
- shtesën e kontratës së shërbyer në llogari rrjedhëse, nr. ***, datë 27.6.2003.

Komisionit, në analizë të deklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara, i rezultoi se:

- Pasuria e deklaruar në deklaratën “Vetting”, apartament me sip. 111 m², lagjja “***”, Berat, për të cilën arsyetohet më sipër, është hipotekuar për përfitimin e vlerës 20.000 euro.

- Sikurse kontrata e kredisë shërbyer me llogari rrjedhëse nr. ***, datë 27.6.2003, nuk ka të shprehur qëllimin e përfitimit të saj, edhe kontrata shtesë për hipotekimin e shtëpisë në favor të bankës, me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë, nuk ka të parashikuar qëllimin e marrjes së kësaj kredie në vlerën 20.000 euro.

- Ndërsa, konstatohet një tjetër kontradiktë edhe në marrëveshjen shtesë të financimit të nënshkruar midis subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit të saj dhe “Alpha Bank”, ku ndër të

⁴ Referojuni pyetësorit, datë 23.9.2019, në dosjen e Komisionit.

tjera, në germën “b”, të nenit 5 të saj, citohet shprehimisht: “...kredimarrësi deri në shlyerjen e plotë të të gjithë detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo hua, përveç kushteve të kësaj marrëveshjeje, detyrohet ...b) të mos nxjerrë jashtë ndërmarrjes në tërësi, të tërheqë një pjesë ose të gjithë makineritë”.

- Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me shoqërinë “K***” sh.p.k., Berat, i rezultoi se punimet e objektit ku ka marrë apartamentin subjekti i rivlerësimit kanë përfunduar që në dhjetor të vitit 2002. Sipas librave të shitjes të depozituara nga kjo shoqëri nuk konstatohen pagesa të mandatarkëtimeve për llogari të subjektit apo të bashkëshortit të saj, por çdo “e dhënë”, në këto libra shitjeje i përket faturimeve të bëra për llogari të shoqërisë. Në kushte të tilla pretendimi i subjektit, se pagesa para disbursimit të kredisë në vlerën 6.610 USD ka të bëjë me kontabilitetin e shoqërisë, nuk qëndron.

Përgjigjja e konfirmuar nga shoqëria “K***” sh.p.k., nuk provon se data në të cilën është paguar vlera 6.610 USD është përdorur për të sistemuar kontabilitetin e shoqërisë dhe, për rrjedhojë, Komisionit i krijohet bindja se kjo pagesë nuk ka pasur si burim krijimi kredinë në vlerën 20.000 euro të marrë në “Alpha Bank”.

Komisioni kreu analizën financiare, nisur nga parashikimet kontraktore, treguesit e të cilës pasqyrohen në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Datë 9.4.2003
1	TË ARDHURA	3,422,136
	Të ardhura subjekti 1998 - 2002	1,730,443
	Të ardhura bashkëshorti 1998 - 2002	1,394,382
	Të ardhura subjekti janar - mars 2003	154,766
	Të ardhura bashkëshorti janar - mars 2003	142,545
2	SHPENZIME	1,968,759
	Shpenzime jetese 2003 sipas ILDKPKI-së	93,864
	Shpenzime jetese (1998 - 2002) 60% e të ardhurave	1,874,895
3	PASURI	3,000,000
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament 2+1, me sip. 110 m ² , lagjia “***”, Berat	3,000,000
	DIFERENCA (1-2-3)	-1,546,623

Komisionit, në analizë të fakteve dhe të rrethanave të lartpërmendura, si dhe nga kryerja e analizës financiare, i rezultoi dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën⁵ e provës se:

- i. Dukej se subjekti nuk kishte pasur burime financiare në vlerën 1.546.623 lekë për të investuar në blerjen e kësaj pasurie, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.
- ii. Dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë në deklaratën “Vetting”, se për blerjen e kësaj pasurie burim krijimi është kredia në vlerën 20.000 euro.
- iii. Dukej se kishte mospërputhje midis deklaramit të subjektit në deklaratën “Vetting”, se burim i krijimit të kësaj pasurie ishte kredia në vlerën 20.000 euro dhe pagesave të

⁵ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5 të, nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

kryera përpara disbursimit të saj në vlerën 9.110 USD ose rreth 8.000 euro dhe pas disbursimit të kredisë në vlerën 14.890 USD, ose rreth 13.000 euro.

- iv. Dukej se kredia në vlerën 20.000 euro nuk kishte pasur destinacion njërin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera në prapësime e saj, ka parashtruar se gjithë paqartësia krijohet nga realizimi i kontratës noteriale me nr. ***, datë 9.4.2003, midis blerësit dhe shitësit, shoqërisë “K***” sh.p.k., nënshkruar nga të dyja palët, ku në përmbajtje të saj ka paragrafin “*e gjithë shuma prej 3.000.000 lekësh, është marrë në dorëzim jashtë zyrës noteriale*”. Hartimi i saj gjen mbështetje në dispozitat e Kodit Civil të kohës.

Subjekti ka deklaruar se kontrata me nr. ***, datë 9.4.2003, është bërë në mirëbesim midis palëve dhe se ka pasur si synim krijimin e kolateralit për t’u vënë garanci hipotekore për bankën që do t’i mundësonte kredinë, dhe se prej fillimit të kontakteve me shoqërinë “K***” sh.p.k., në mars të vitit 2002, ka deklaruar se e vetmja mundësi likuidimi është kredia bankare, dhe se për realizimin e saj, për të vënë pasuri në hipotekë në favor të bankës, nuk kishte asnjë të tillë, dhe se pas martese ka jetuar në shtëpi me qira.

Marrëdhënia me shoqërinë “K***” sh.p.k., ka nisur në mars të vitit 2002. Subjekti ka deklaruar: “*Bashkëshorti është punësuar në “Alpha Bank”, Berat, në shkurt të vitit 2002. Në atë periudhë, në qytetin e Beratit nuk kishte asnjë institucion financiar që jepte kredi për shtëpi. ‘Alpha Bank’ mund të jepte kredi për shtëpi, pra, mund të na mundësonte dhënien e kredisë. Ky është momenti që u futëm në marrëveshje verbale me shoqërinë ‘K***’ sh.p.k., që kishte në proces ndërtimi pallatin në të cilin donim të merrnim apartamentin. Për rrjedhojë, u lidh kontrata. Në kontratë nuk ka të parashikuar kushte të cilat të mund të kufizonin regjistrimin e kësaj pasurie, pasi palët në marrëveshje verbale dhe mirëkuptim të plotë, bien dakord për funksionimin e një kontrate të tillë.*”

Subjekti ka deklaruar se ka nënshkruar një kontratë “tip”, pa u interesuar thellë për përmbajtjen, se qëllimi i saj lidhet me mundësinë për të realizuar marrjen e kredisë dhe se ka gjetur mirëkuptimin e palës shitëse, e cila do të përfitonte shumën e kredisë dhe kjo ka ndodhur në të vërtetë. Subjekti pretendon se nuk mund të penalizohet për shprehjen “*e gjithë shuma prej 3.000.000 lekësh është marrë në dorëzim jashtë zyrës noteriale*”. Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit. Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin e fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të ketë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt. Fjalët dhe shprehjet që mund të kenë dy kuptime, duhet të merren në kuptimin më të përshtatshëm me natyrën e kontratës. Po ashtu, ndër të tjera, subjekti ka vijuar të parashtronte se kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët. Subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur mundësi financiare deri në datën 9.4.2003 për të likuiduar blerjen e apartamentit dhe për këtë fakt i është drejtuar bankës për kredi. Shoqëria “K***” sh.p.k., ka mundësuar nxjerrjen e hipotekës për pallatin e ndërtuar prej saj, pasi ka qenë e interesuar për shitjen e apartamentit, pra, ka mundësuar kolateral për kredinë bankare dhe vlera e kredisë, ashtu sikurse subjekti ka deklaruar, i është dhënë shoqërisë.

- Gjithashtu, subjekti, ndër të tjera, në lidhje me qëllimin e marrjes dhe të përdorimit të kredisë, ka cituar parashikimin e bërë në nenin 1 të marrëveshjes shtesë të financimit ku thuhet: “*Huaja jepet me afat prej 15 vjetësh që fillon nga dita e parë e disbursimit me shlyerje me këste tremujore me qëllim të vetëm blerje dhe rikonstruksion apartamenti*”.

Qëllimi i kredisë, ka cituar subjekti, është i mirëpërcaktuar në nr. 1 (një) të kontratës dhe në mandatarkëtimet e lëshuara nga shoqëria ndërtuese “K****” sh.p.k. Fakti se gjatë gjithë periudhës së gjatë të kohës nuk lindën probleme mes palëve kontraktuese, pasi ato kanë qenë në mirëbesim mes njëra-tjetrës, mes marrëdhëniesh të rregullta njerëzore apo fakti që shlyerja e kredisë ka vazhduar rregullisht në “Alpha Bank”, Berat, duke mos lindur probleme dhe me këtë të fundit, janë prova të plota dhe të pakundërshtueshme, bindëse dhe të vërteta, se pagesa për blerjen e shtëpisë, shoqërisë “K****” sh.p.k., e ka burimin e vetëm te kredia e marrë në “Alpha Bank”, Berat, dhe për pasojë, subjekti është shprehur se nuk ka kryer deklaram të rremë.

Subjekti ka deklaruar se kjo kredi nuk është përdorur as për mobilim, as për depozitë bankare, blerje automjeti, apo për biznes, sepse do të kishte lënë gjurmë në një regjistër publik. Kredia është marrë në monedhën euro, pasi paga e bashkëshortit të subjektit, i punësuar në “Alpha Bank”, Berat, në vitin 2003, jepej në monedhën euro dhe në këtë mënyrë nuk do të kishte problem për lëvizjet e kursit të këmbimit për shlyerjen e kredisë. Paga në euro e bashkëshortit të subjektit është deklaruar edhe në deklaratat periodike për vitet 2003, 2004 dhe 2005, ku është bërë edhe ndërprerja e marrëdhëniesh të punës së bashkëshortit me “Alpha Bank”.

- Subjekti ka depozituar shkresat nr. *** prot., datë 15.11.2018 dhe nr. *** prot., datë 18.11.2011, me përgjigjet mbi qëllimin e marrjes së kredisë dhe termave të përdorur në nenin 5 të marrëveshjes shtesë të financimit.

- Në lidhje me pagesën e kryer sipas mandatarkëtimin të datës 1.7.2003, në shumën 6.610 USD, subjekti ka parashtruar, ndër të tjera, se termi *“ka lidhje me kontabilitetin e shoqërisë”* se mandatarkëtimi është dokument kontabiliteti, nuk do të thotë se me këtë arkëtim shoqëria rregullon ndonjë problem të saj kontabël. Fakti që mandati ka datën 1.7.2003, mund të jetë lapsus nga përpiluesi, siç ndodh në shumë raste në punën e përditshme ku data dhe emërtime në krye të dokumenteve mbeten të mbartura dhe absolutisht nuk mund të jetë vënë nga subjekti. Data 1.7.2003 në mandatarkëtimin me vlerën 6.610 USD është një gabim rutinë në përpilimin e dokumentit prej vetë shoqërisë, pa u vënë re nga subjekti dhe bashkëshorti i saj. Në deklaratën periodike të vitit 2004, në rubrikën *“data dhe viti i krijimit për shtëpinë e banimit në Berat”*, është deklaruar data 27.6.2004. Është shënuar gabimisht, një gabim rutinë, ndoshta është pasur parasysh data e kredisë 27.6.2003, data e nënshkrimit të kredisë. Ky gabim nuk ndikon në përmbajtjen e deklaratës.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ, përgjigjet e dhëna nga subjekti në pyetësorë, si dhe parashtrimet e saj në prapësime, arsyeton si vijon:

- Në lidhje me mungesën e burimeve financiare në vlerën 1.546.623 lekë për të investuar në blerjen e kësaj pasurie, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, trupi gjykues konstaton se subjekti, me gjithë shpjegimet e dhëna, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor ndryshimin e situatës financiare. Mungesa e burimeve financiare për këtë pasuri ka ardhur si rezultat i analizës së akteve të depozituara nga subjekti, konkretisht kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie datë 9.4.2003, mandatpagesat e depozituara nga subjekti dhe nga shoqëria ndërtimore “K****” sh.p.k., me cilësinë e palës shitëse, të cilat konfirmojnë faktin se pasuria është regjistruar, pasi ishin shlyer vetëm 2.500 USD, ndërsa sipas kontratës së shitjes, me nënshkrimin e saj, ishin shlyer 3.000.000 lekë.

Trupi gjykues, në analizë të këtyre provave, ka ndjekur kronologjinë e shtrirjes së efekteve të kontratës së shitjes, pagesën e plotë të shlyer për këtë pasuri sipas kësaj kontrate, kushtin apo rezervën që mund të kishte ky akt, si dhe çdo element tjetër të saj.

Në këtë kontekst, trupi gjykues ka konstatuar se kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie nuk është paraprirë nga një kontratë porosie apo sipërmarrjeje, nuk ka parashikuar asnjë kusht, pra, i ka

shtrirë efektet e regjistrimit të saj në mënyrë të menjëhershme, me vullnetin e palëve kontraktore, veprim i cili ndodh padyshim vetëm pas kalimit të pagesës në favor të shitësit.

Po sipas kësaj kontrate rezulton se pagesa prej 3.000.000 lekësh për blerjen e pasurisë është shlyer nga blerësi me nënshkrimin e saj, çka faktori se pala shitëse me nënshkrimin e kontratës është zhveshur nga pronësia dhe pala blerëse është bërë zotëuese e pasurisë.

Duke iu referuar zbatimit të kontratës, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë me dokumentacion justifikues deri në nënshkrimin e kontratës së shitjes, konkretisht tri mandatpagesa për shlyerje të kësaj pasurie, përkatësisht: në datën 20.3.2002 ka rezultuar se subjekti ka arkëtuar me mandatarkëtimin nr. ***, vlerën 500 USD; në datën 27.8.2002 ka arkëtuar me mandatarkëtimin nr. ***, vlerën 1.000 USD; dhe në datën 8.11.2002 ka arkëtuar me mandatarkëtimin nr. ***, vlerën 1.000 USD, pra, në total ka arkëtuar vlerën 2.500 USD. Në të tilla kushte konstatimi i balancës negative mbetet i pandryshuar dhe për pasojë nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të pasurisë.

Në lidhje me deklarin e subjektit të rivlerësimit se ka përdorur si burim krijimi të kësaj pasurie kredinë e marrë në “Alpha Bank”, në vlerën 20.000 euro në korrik të vitit 2003, trupi gjykues mban në konsideratë faktet e dala nga hetimi, të cilët e bëjnë të pabesueshëm provueshmërinë e burimit të ligjshëm të kësaj pasurie me këtë kredi.

Së pari – kredia është përfituar me kontratën nr. ***, datë 27.6.2003, dhe është disbursuar në datën 2 korrik 2003, pra, rreth tre muaj më pas nga regjistrimi i pasurisë në hipotekë.

Së dyti – megjithëse pasuria ishte hipotekuar në prill të vitit 2003, subjekti ka shlyer sipas mandatarkëtimin nr. ***, datë 1. 7.2003, vlerën 6.610 USD, pra, një ditë përpara disbursimit të kredisë, shumë e cila nuk rezulton të ketë si burim këtë të fundit. Pra, edhe në rast se do të merrej e mirëqenë se kredia ka pasur si destinacion blerjen e kësaj pasurie, nuk rezulton që e gjithë shuma e përfituar të ketë shkuar në favor të blerjes së saj dhe për pasojë përsëri konstatimi se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e kësaj pasurie qëndron dhe merr vlerë në hetimin tërësor të kriterit të pasurisë të subjektit.

Së treti – subjekti pretendon se nuk ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e shumës për këtë pasuri në kohën e nënshkrimit të kontratës dhe se është realizuar në mirëbesim mes palëve. Për të provuar të qenurit në kushtet e mirëbesimit, subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues kohën kur kishte aplikuar për kredi, ecurinë e aplikimit apo paraqitjen e ndonjë kërkesë për përshpejtimin e përfitimit të kredisë, komunikimin e mbajtur me bankën, për më tepër në kushtet kur bashkëshorti i subjektit ishte në atë kohë punonjës pranë të njëjtës bankë kredidhënëse dhe presupozohet se ishte i mirënjohur me mënyrat e aplikimit, si dhe kohën e nevojshme të përfitimit. Trupi gjykues ka konstatuar ekzistencën e një periudhe të largët kohore prej nënshkrimit dhe regjistrimit të kontratës në hipotekë me përfitimin e kredisë, çka do të thotë se subjektit, nëse i nevojitet kredia për blerjen e pasurisë, minimalisht do të kishte aplikuar në kohën që ka nisur marrëdhënien me shoqërinë ndërtimore, pra, prej nisjes së pagesës së kësteve në vitin 2002 apo në vijim gjatë negociatave të nënshkrimit të kontratës së shitjes, apo edhe në kohën e nënshkrimit të saj. Në vijim, nëse një veprim i tillë do të kishte ndodhur, kurrsesi procedura për përfitimin e kredisë nuk do të kishte marrë tre muaj, përlllogaritur minimalisht sikur subjekti të kishte aplikuar për kredi në kohën e regjistrimit të pasurisë në hipotekë. I njëjti arsyetim, për sa i përket faktorit kohë, do të ishte edhe nëse subjekti pretendon se e ka regjistruar pasurinë me qëllimin e vetëm për ta vënë kolateral në përfitimin e kredisë.

Së katërti – Pretendimi i subjektit në prapësime se data e shënuar në mandatpagesën për shumën 6.610 USD (konstatuar se është paguar pas nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë në hipotekë, por edhe përpara disbursimit të kredisë) është shkruar gabim, është lapsus, apo është rutinë e punës së shoqërisë, bie në kundërshtim me vetë deklarin e subjektit në pyetësorë se kjo pagesë është përdorur për të sistemuar kontabilitetin e shoqërisë. Nga ana tjetër, edhe nëse do të vlerësonim pagesat e kryera sipas mandatpagesave:

datë 3.7.2003, në vlerën 6.890 USD; datë 4.7.2003, në vlerën 4.000 USD; datë 5.7.2003, në vlerën 4.000 USD, pagesa të shlyera pas disbursimit të kredisë, përsëri subjekti do të gjendej në balancë negative.

Së pesti – është konstatuar se në kontratën e kredisë nuk është parashikuar qëllimi i marrjes së saj. Është fakt se qëllimi i marrjes së kredisë është parashikuar në marrëveshjen shtesë të financimit, por mënyra e parashikuar se kredia është dhënë me qëllim blerje dhe rikonstruksion apartamenti, nisur nga konstatimi se arredimi i kësaj pasurie ka pasur relativisht një kosto të lartë, sikurse do të trajtohet në vijim të vendimmarrjes, krijon bindjen për trupi gjykues se kredia nuk ka pasur destinacion blerjen e pasurisë, objekt hetimi administrativ.

Nën këtë arsyetim, trupi gjykues vlerëson se faktet e dala nga hetimi me vlerë provuese, konkurrojnë dukshëm në raport me pretendimet e subjektit. Në këto kushte, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, arrin në konkluzion se:

- i. Subjekti ka mungesë financiare në vlerën 1.546.623 lekë për të blerë këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.
- ii. Subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për shkak të mospërputhjeve të rezultuara midis deklaramit të tij në deklaratën “Vetting” se burim i krijimit të kësaj pasurie ishte kredia në vlerën 20.000 euro dhe pagesave të kryera përpara disbursimit të saj në vlerën 9.110 USD ose rreth 8.000 euro dhe pas disbursimit të kredisë në vlerën 14.890 USD ose rreth 13.000 euro.
- iii. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë se kredia në vlerën 20.000 euro ka pasur destinacion njërin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie, dhe për pasojë në tërësi për këtë pasuri ka bërë deklaram të pamjaftueshëm referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Në lidhje me automjetin e tipit “Ford Fiesta”, me targa *, sipas kontratës datë 15.11.2006, në vlerën 250.000 lekë. Burim i krijimit: të ardhurat nga paga. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶.**

ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: deklarami i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.

Hetimi i kryer nga Komisioni

- Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2006.

- Kjo pasuri është blerë me kontratën e shitjes nr. *** rep., datë 15.11.2006, në vlerën 250.000 lekë.

Me shkresën nr. ***prot., datë 8.1.2019, DPSHTRR-ja konfirmon automjetin me targa ***në pronësi të znj. Marjana Velçani, deri në momentin e deklaratës “Vetting”.

Rezulton se në datën 2.2.2018 ky mjet është nxjerrë jashtë përdorimit, konfirmuar kjo me vërtetimin nr. *** prot., datë 2.2.2018, nga DPSHTRR-ja, Drejtoria Rajonale Berat.

Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë financiare të blerjes së kësaj pasurie, treguesit e të cilës pasqyrohen në tabelën nr. 2.

⁶ Kontratë shitje (automjeti) nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2006
1	TË ARDHURA	1,676,922
	Të ardhura nga paga subjekti	897,990
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	778,932
2	SHPENZIME	1,081,947
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	438,228
	Shpenzime kredia në “Alpha Bank” (20.000 euro)	121,593
	Shpenzime shkollimi për vajzën	40,000
	Shpenzime arredimi, ap. Berat	436,356
	Shpenzime <i>TIMS</i>	45,770
3	PASURI	1,024,317
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Makinë “Ford Fiesta”, me targa ***	250,000
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	774,317
	DIFERENCA (1-2-3)	-429,341

Komisionit, nga analiza financiare, i rezultoi dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën⁷ e provës se, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në vlerën 429.341 lekë për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera në parashtrimet e saj, ka deklaruar se shuma për arredimin e shtëpisë në qytetin e Beratit ka qenë në vlerën 321.000 lekë, përtej çdo dyshimi nga shifrat e prodhuara nga ish-Banka Popullore – Societe General Albania – sot OTP Bank. Nën këtë deklaram subjektit pretendon se zëri i shpenzimeve për arredimin është i lartë, për shkak se është përlllogaritur nga Komisioni sipas vlerës së arredimit të pasqyruar në praktikën e kësaj banke.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues konstaton se balanca negative është rezultat i shumave të pasqyruara në zërin “*arredimi i apartamentit në Berat*”, për shkak të diferencës së lartë që është konkluduar nga shpenzimet e pretenduara nga subjekti lidhur me arredimin e pasurisë dhe shpenzimet e pasqyruara në një praktikë bankare të analizuar nga Komisioni, administruar për një tjetër kredi (në vlerën 2.700.000 lekë) të përfituar nga subjekti në ish-Bankën Popullore (Societe General Albania), sot OTP Bank, në vitin 2009, me qëllim krijimin e pasurisë nr. 3, pasqyruar më poshtë.

Trupi gjykues, nga përlllogaritjet financiare, ka konstatuar balancë negative, duke analizuar të gjithë të ardhurat e përfituara për vitin 2006, si dhe shpenzimet apo detyrimet financiare të subjektit përgjatë këtij viti kalendarik.

Në deklaramin e saj në pyetësorin standard, por edhe në vijimësi gjatë hetimit, si dhe në raprësime, subjekti i ka qëndruar faktit se arredimi i apartamentit në Berat është kryer përgjatë

⁷ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

viteve 2002 deri në 2006 dhe se vlera e shpenzuar ka qenë 321.000 lekë. Ndërsa, në praktikën e kredisë bankare në vlerën 2.700.000 lekë, Komisioni ka konstatuar se arredimi i këtij apartamenti është pasqyruar në vlerën 2.030.000 lekë.

Shpenzimi i kryer për arredimin e shtëpisë është përlllogaritur nga Komisioni sipas vlerës së pasqyruar në praktikën bankare, pjesëtuar në mënyrë të barabartë nga viti 2002 deri 2006, sikundër ka deklaruar subjekti për kohën e arredimit dhe, për pasojë, vlera 436.356 lekë (pasqyruar në tabelën nr. 2), e rezultuar për vitin 2006 si shpenzim i kryer për arredimin e kësaj pasurie, pothuajse, përkon me balancën negative të pasqyruar në tabelën më sipër.

Duke qenë se subjekti nuk arriti të bindë Komisionin me prova shkresore, mbi shumën e pretenduar për arredimin e shtëpisë në qytetin e Beratit, (për të cilën arsyetohet më gjerësisht në pikën nr. 12 më poshtë), në raport me shumën e pasqyruar në praktikën bankare, pasi nuk paraqiti asnjë dokument provues për shpenzimet e kryera, por pretendoi vetëm në nivel deklarativ, trupi gjykues konkludon se balanca negative nuk ndryshon dhe, për pasojë, subjekti ka mungesë financiare në vlerën 429.341 lekë për blerjen e automjetit të tipit “ Ford Fiesta”.

Baza ligjore

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundim se:

- Në tërësi, për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3. Në lidhje me apartamentin me sip. 110.9 m² + garazh, ndodhur në Rr. “****”, Yzberisht, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 9.7.2009, me vlerë 45.000 euro.

Burim krijimi: kredi në vlerën 2.700.000 lekë në Bankën Popullore, dega Berat; të ardhura nga pagat në vlerën 2.100.000 lekë. Detyrimi i mbetur në vlerën 4.000 euro (deklaruar në rubrikën detyrime financiare). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁸.

ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se: referuar kontratës së sipërmarrjes, datë 9.7.2009, z. A. V., porositi apartamentin me sip 110.9 m² dhe një garazh me sip. 22 m², ndodhur në Rr. “****”, Yzberisht, Tiranë. Vlera e apartamentit është 37.000 euro dhe vlera e garazhit 8.000 euro, në vlerën totale 45.000 euro. Referuar deklaratës së interesave private periodike vjetore të vitit 2009, subjekti ka deklaruar vetëm porositetin e apartamentit të banimit dhe jo të garazhin.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti ka deklaruar për këtë pasuri:

- Në deklaratën për vitin 2009 me përshkrim: kontratë sipërmarrje, blerje apartamenti, në vlerën 45.000 euro, por pa deklaruar burimin e krijimit as edhe pjesën takuese dhe, po në këtë deklaratë, ka deklaruar kredinë në Bankën Popullore Berat, për blerje apartamenti në vlerën 2.700.000 lekë.

- Në deklaratën për vitin 2011, subjekti deklaron si adresë qëndrimi: Lagjja “****”, Rr. “****”, Tiranë.

- Në deklaratën për vitin 2013, subjekti deklaron si adresë banimi: Rr. “****”, pallati “****”, Yzberisht, Tiranë.

- Me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, Komisioni i është drejtuar ZQRPP-së.

⁸ Vërtetim, nr. extra prot, datë 28.10.2016, nga Societe Generale Albania; kontratë kredie bankare afatgjatë, nr***kol., datë 27.7.2009; kontratë sipërmarrjeje datë 9.7.2009, në dosjen e ILDKPKI-së.

Me shkresën nr. ***prot., datë 11.1.2019, ZVRPP-ja Tiranë nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

- Me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, Komisioni i është drejtuar OSHEE-së.

Me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2018, ky institucion informon se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë kontrata me OSHEE-në. Subjekti, në përgjigje të kërimit të Komisionit, ka depozituar librezën përkatëse, nga ku rezulton se kjo kontratë energjie ka titullar bashkëshortin e subjektit.

- Me shkresën nr.***prot., datë 18.12.2018, Komisioni i është drejtuar UKT-së.

Me shkresën nr. ***prot., datë 22.1.2019, UKT-ja ka konfirmuar se z. A. V. identifikohet abonent me kontratën me nr. ***, me adresë: Rr. “****”, Tiranë.

Nga aktet e administruara gjatë hetimit⁹ rezulton se për këtë pasuri është lidhur kontrata e sipërmarrjes në datën 9.7.2009, midis investitorit shoqërisë “A****” sh.p.k., dhe bashkëshortit të subjektit, z. A. V. .

Në nenin 4 të kësaj kontrate, “çmimi i shitjes”, është përcaktuar se vlera e apartamentit është 37.000 euro dhe vlera e garazhit është 8.000 euro. Vlera totale (apartament + garazh) është 45.000 euro.

Me nënshkrimin e kontratës thuhet se likuidohet vlera prej 3.000.000 lekësh dhe pjesa tjetër do të likuidohet brenda muajit korrik të vitit 2009.

Komisioni ka pyetur subjektin¹⁰ mbi likuidimin e kësaj pasurie, nga ku rezulton se pagesat janë kryer, si më poshtë:

Mandatarkëtim datë 6.3.2009	1,500,000 lekë
Transaksion bankar “Banka Popullore”, datë 27.7.2009	2,600,000 lekë
Mandatarkëtim datë 5.9.2009	600,000 lekë
Mandatarkëtim datë 24.12.2009	200,000 lekë
TOTAL	4,900,000 lekë

Nga sa më sipër vërehet se nuk përputhen datat e pagesës me parashikimet kontraktore.

Pagesa për këstin e dytë, në vlerën 2.600.000 lekë në datën 27.7.2009, ka si burim të deklaruar disbursimin e kredisë prej 2.700.000 lekësh, në po të njëjtën datë në “Societe Generale Albania”¹¹, (ish-Banka Popullore). Nga verifikimi i kontratës së kredisë me nr. ***, datë 27.7.2009, rezulton se është nënshkruar në prani të noterit me zyrë noteriale Berat, ndërsa në po të njëjtin akt kontraktor, ku dhe përshkruhet numri i repertorit dhe i kolisë së kontratës, juridiksioni i përket Dhomës së Noterisë Vlorë.

Subjekti, në deklaratën e vitit 2009, nuk deklaron detyrime financiare ndaj firmës së ndërtimit, ndërsa në vitin 2016 deklaron detyrim prej 4.000 euro, për shlyerje në momentin e hipotekimit të kontratës së sipërmarrjes.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2019, nga “Societe Generale Albania”, në dosjen e kredisë.

Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2019, nga OTP Bank në dosjen e kredisë. Aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰ Pyetësor nr. 2, datë 18.7.2019.

¹¹ Kontratë kredie nr. ***, datë 27.7.2009.

Komisioni ka marrë si kurs këmbimi për këtë pasuri, kursin e datës së nënshkrimit të kontratës. Nga arkiva e kursit të këmbimit në Bankën e Shqipërisë¹² rezulton se në datën 9.7.2009, kursi i këmbimit euro/lekë ka qenë 1 euro = 128.86 lekë.

Si rrjedhim i kësaj përlllogaritjeje, detyrimi i mbetur për firmën e ndërtimit është në vlerën 898.700 lekë, vlerë kjo që nuk përputhet me vlerën 4.000 euro (ose 515.440 lekë), të deklaruar nga subjekti në deklaratën për vitin 2016. Pra, rezulton mospërputhje për detyrimin e mbetur prej 383.260 lekësh.

Nga hetimi administrativ, në dosjen e kredisë së ish-Bankës Popullore¹³, përkatësisht në titullin “komente mbi pasqyrat financiare”, deklarohet se subjekti ka marrë edhe një kredi në vlerën 7.000 euro për blerjen e dhomës së fëmijëve dhe për pagesën e automjetit dhe detyrimi sot është 0 (zero), pasi klienti e ka mbyllur me paratë e tij. Bashkëngjitur këtij dokumenti, banka ka dërguar raportin e Bankës së Shqipërisë mbi kreditë, ku pasqyrohet vlera prej 7.000 euro.

Komisioni, për një hetim më të thelluar, ju drejtua Bankës së Shqipërisë¹⁴ për më shumë informacion mbi këtë kredi, e cila informoi se kredia prej 7.000 euro, e marrë në datën 5.12.2008, ishte marrë në “Alpha Bank”, por nuk dispononte dokumentacion sepse kjo kredi ishte shlyer dhe kishte kaluar afati ligjor për ruajtjen e të dhënave prej 5 vjetësh nga data e shlyerjes.

Komisioni iu drejtua “Alpha Bank”¹⁵ për dosjen e plotë të kësaj kredie nga ku rezultoi¹⁶ se konfirmohet që kjo kredi nuk është një kredi e re, por vazhdimësi e asaj në vlerën prej 20.000 euro e marrë në datën 2.7.2003 për të cilën është sqaruar në pasurinë e parë.

Komisioni kreu analizën financiare me informacionin e deritanishëm, treguesit e të cilës pasqyrohen në tabelën nr. 3.

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	2009
1	TË ARDHURA	1,710,677
	Të ardhura nga paga subjekti	1,005,670
	Të ardhura nga paga bashkëshorti	705,007
	Të ardhura nga interesat	4,929
2	SHPENZIME	(2,085,778)
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	546,480
	Shpenzime kredia në “Alpha Bank” (20.000 euro)	762,177
	Shpenzime kredia në “Societe Generale Albania” (2.700.000 lekë)	(2,560,735)
	Detyrim në momentin e hipotekimit me “Alpha Bank” nga viti 2009	(898,700)
	Shpenzime arredimi, apartament Tiranë	65,000
3	PASURI	3,285,243
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	

¹² https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

¹³ Shkresë nr. *** prot., nga Societe Generale Albania Bank.

¹⁴ Shkresë nr.***prot., datë 22.7.2019, nga Banka e Shqipërisë.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 6.9.2019, e Komisionit.

¹⁶ Sipas e-mail-it datë 2.10.2019, të dërguar nga “Alpha Bank”

	Kontratë sipërmarrje (blerje apartamenti) datë 9.7.2009, sip. 110.9 m ² +garazh 22 m ²	5,798,700
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	(2,513,457)
	DIFERENCA (1-2-3)	511,212

Komisionit, nga analiza financiare, i ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të investuar në blerjen e kësaj pasurie të paluajitshme, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

Ndërsa, i ka rezultuar dhe, për pasojë, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime se:

- i. Dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë në deklaratën për vitin 2009 dhe në vijim deri në deklaratën “Vetting”, pasi nuk kishte deklaruar pasurinë garazh dhe as burimin e krijimit të blerjes së këtyre pasurive.
- ii. Dukej se çmimi 363.6 euro/m² për blerjen e garazhit ishte më i lartë se sa çmimi 333.6 euro/m² për blerjen e apartamentit të banimit.
- iii. Dukej se kishte mospërputhje midis juridiksionit të dhomës së noterisë për hartimin e kontratës së kredisë nr. ***, datë 27.7.2009, pasi i përket rrethit Vlorë dhe tekstit të saj ku pasqyrohet se kontrata është hartuar në prani të noterit me zyrë noteriale Berat.
- iv. Dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë për vlerën 383.260 lekë mbi detyrimin e mbetur ndaj investitorit, pasi subjekti deklaronte vlerën 4.000 euro (e barabartë me shumën 515.440 lekë), si detyrim të mbetur, ndërkohë që nga hetimi rezultoi se detyrimi i mbetur është në vlerën 898.700 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 ka deklaruar vlerën e plotë 45.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes, duke shënuar vetëm shtëpi banimi, pa përmendur ndarjen shtëpi + garazh, dhe se pasuria ka pasur si burim kredinë dhe të ardhurat nga paga. Subjekti ka sqaruar se fjala garazh nuk përmendet, por vlera e tij është deklaruar sepse është brenda vlerës 45.000 euro. Çmimi i garazhit ka qenë çmim tregu i vendosur nga shoqëria ndërtuese dhe nuk i lihet në dorë blerësit ta përcaktojë.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se për sa i përket noteres A. B. ka qenë dhe është me seli në Berat, përballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, dhe se lidhur me juridiksionin në Berat në rastin e kontratës së sipërmarrjes, apo në Vlorë në rastin e dokumentacionit të kredisë, ka sqaruar se është një problem, që si klientë nuk kanë ndikuar dhe nuk kanë pasur dijeni.

Subjekti, për sa i përket detyrimit të mbetur për shoqërinë “A****” sh.p.k., për apartamentin, ndodhur në Rr. “****”, Yzberisht, Tiranë, ka sqaruar se është thirrur nga ILDKPKI-ja në datën 16.11.2011 dhe ka deklaruar se detyrimi me firmën ndërtuese është 4.000 euro, shifër e cila buronte nga rakordimi i bërë me firmën ndërtuese. Nga ILDKPKI-ja nuk i është kërkuar dokumentacion. Ka parashtruar se këmbimi nga lekë në euro me shoqërinë e ndërtimit është llogaritur me kursin e tregut të lirë dhe jo me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Subjekti ka depozituar procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 16.11.2011 dhe rakordimin me shoqërinë ndërtuese “A****” sh.p.k., me përfaqësues ligjor, z. G. D. .

Vlerësimi i Komisionit

- Trupi gjykues, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dokumentacionit të administruar, konstaton se qëndron pasaktësia në deklarimin e bërë nga subjekti në deklaratën periodike për vitin 2009, lidhur me deklarimin e shtëpisë dhe jo të garazhit, por duke vlerësuar se është deklaruar vlera e plotë që i përket të dy pasurive, apartament dhe garazh

marrë së bashku dhe konkludon se kjo pasaktësi nuk ndikon në vlerësimin tërësor të vendimmarrjes.

- Po ashtu, edhe lidhur me mosrakordimin e vlerës për m², të konstatuar nga përlllogaritjet e kryera, për blerjen e pasurisë garazh, nga ku rezultoi se ishte më e lartë se ajo për apartamentin, por nisur edhe nga shpjegimi i subjektit *se çmimi i garazhit ka qenë çmim tregu i vendosur nga shoqëria ndërtuese dhe se nuk i lihet në dorë blerësit ta përcaktojë*, trupi gjykues nuk konkludon mbi ndonjë problematikë dhe, për pasojë, në këtë rast nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin.

- Gjithashtu, trupi gjykues identifikon si pasaktësi mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike për vitin 2009, por proporcionalisht në raport me faktin se nga analiza financiare e kryer për këtë pasuri nuk kanë rezultuar balanca negative, çmon se kjo pasaktësi nuk ndikon në vlerësimin tërësor të vendimmarrjes.

- Trupi gjykues, në lidhje me konstatimin tjetër të Komisionit se detyrimi i mbetur për t'u shlyer për këtë pasuri nuk ishte ai i deklaruar nga subjekti në deklaratën "Vetting" në rubrikën "detyrime financiare" në vlerën 4.000 euro, por ishte 898.700 lekë, konstatim ky i dalë nga përlllogaritjet financiare, analizoi pretendimet e subjektit dhe provat e depozituara në prapësime.

Më konkretisht, subjekti ka pretenduar se vlera e mbetur për t'u shlyer për këtë pasuri ka qenë 4.000 euro, për shkak se është rakorduar me shoqërinë ndërtimore që nga shuma totale e mbetur për t'u shlyer të zbriteshin disa punime të pakryera, të cilat kapnin vlerën prej 250.000 lekësh. Subjekti, për të provuar këtë fakt, ka depozituar procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në, si dhe formatin e rakordimit me shoqërinë ndërtimore.

Trupi gjykues, nga verifikimi i procesverbalit datë 16.11.2011, konstaton se në përgjigje të pyetjes nr. 1, që i përket pikërisht deklarimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike për vitin 2009, ndër të tjera, subjekti ka konfirmuar se për këtë pasuri i ka mbetur pa shlyer ende vlera 4.000 euro. Po ashtu, edhe nga verifikimi i formatit të rakordimit rezulton se vlera e punimeve të pakryera ka qenë 250.000 lekë.

Trupi gjykues konstaton se subjekti, pavarësisht se nuk ka deklaruar në deklaratën për vitin 2009 vlerën e mbetur të pashlyer për këtë pasuri, e ka deklaruar në vitin 2011 nëpërmjet procesverbalit që shërben si provë shkresore dhe jo përgjatë hetimit administrativ apo në prapësime. Kjo është një arsye më shumë për të kuptuar se shuma e mbetur për t'u shlyer është ajo që pretendon subjekti, konkretisht 4.000 euro. Por, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2009, në procesverbalin e datës 16.11.2011, si dhe në deklaratën "Vetting", vlerën 250.000 lekë të zbritur nga shoqëria për punimet e pakryera sipas formatit të rakordimit dhe, për rrjedhojë, rezulton se nuk ka deklaruar në deklaratën "Vetting" vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie pas zbritjes së vlerës 250.000 lekë nga shoqëria ndërtimore.

Baza ligjore

Trupi gjykues, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklarimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për këtë pasuri, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4. Në lidhje me automjetin tip "Peugeot", me targa ***, sipas kontratës datë 7.10.2013, në vlerën 13.400 euro. Burimi i krijimit: vlera 560.000 lekë e marrë kredi në "Alpha Bank",

Tiranë, dhe vlera 9.400 euro të ardhura nga paga. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹⁷.

ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja, nga shoqëria “A***” sh.p.k., nga “Peugeot Albania” dhe “Alpha Bank”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti, për këtë automjet në deklaratën periodike për vitin 2013, ka deklaruar pagesën e kështit paraprak për blerjen e automjetit, sipas kontratës me shoqërinë “A***” sh.p.k., datë 7.10.2013, në vlerën 6.000 euro, me burim krijimi, të ardhurat nga paga, pakësim *cash*.

Në deklaratën periodike për vitin 2014 subjekti ka deklaruar pagesën e kështit për blerjen e automjetit, sipas kontratës me shoqërinë “A***” sh.p.k., datë 7.10.2013, në vlerën 560.000 lekë, me burim krijimi, kredi në “Alpha Bank”, datë 18.2.2014; “makinë tip ‘Peugeot’, me targa ***, në vlerën 13.400 euro, përfituar me kontratën datë 7.10.2013, me shoqërinë “A***” sh.p.k., duke specifikuar përkatësisht se vlera 6.000 euro është paguar në vitin 2013, vlera 4.000 euro është paguar me kredi nga “Alpha Bank” dhe vlera 3.400 euro është detyrim i mbetur”.

Në deklaratën periodike për vitin 2015 ka deklaruar pagesën e kështit sipas kontratës me shoqërinë “A***” sh.p.k., datë 7.10.2013, në vlerën 3.400 euro, me burim krijimi: të ardhura nga paga.

Kjo pasuri konfirmohet me kontratën e shitjes nr. 13.04.024, datë 7.10.2013, lidhur mes shoqërisë “A***” sh.p.k., dhe subjektit të rivlerësimit, si dhe faturës tatimore¹⁸ nr. ***, datë 3.2.2014, në vlerën 13.400 euro ose 1.879.484 lekë.

Mënyra e pagesës: 6.000 euro do të paguhet në një nga llogaritë e shoqërisë “A***” sh.p.k. Diferenca prej 7.400 euro do të paguhet si më poshtë:

- 4.000 euro do të financohet nga “Alpha Bank”;
- 3.400 euro do të paguhet me këste në një nga llogaritë e shoqërisë “A***” sh.p.k., brenda 2 vjetësh nga momenti i dorëzimit të automjetit.

Komisioni ka pyetur subjektin¹⁹dhe shoqërinë “A***” sh.p.k., mbi likuidimin e këtij automjeti.

Informacioni i dërguar nga subjekti përputhet me informacionin e dërguar nga shoqëria²⁰.

Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se me kontratën e datës 7.10.2013, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin e tipit “Peugeot” nga shoqëria “A***” sh.p.k., në shumën 13.400 euro, ku është përfshirë edhe zhdoganimi i mjetit. Në kontratë, në pikën 8 (8.1) të saj, është përcaktuar se pagesa do të shlyej: vlera 6.000 euro do të paguhej në një nga llogaritë e shoqërisë “A***” sh.p.k., ndërsa diferenca prej 7.400 euro do të paguhej përkatësisht, në vlerën 4.000 euro do të financohen nga “Alpha Bank” dhe diferenca prej 3.400 euro do të paguhej me këste në një nga llogaritë e shoqërisë brenda dy viteve nga momenti i dorëzimit të automjetit.

Për sa më sipër, Komisionit i rezultoi se ky automjet është shlyer plotësisht, si më poshtë:

- mandatarkëtimi për shumën 6.000 euro, në datën 7.10.2013;
- transaksion bankar në shumën 560.000 lekë²¹, në datën 19.2.2014, në “Alpha Bank”;

¹⁷ Deklaratë datë 24.10.2016, e “Alpha Bank”; kontratë huaje nr. ***, datë 6.2.2014; kontratë nr. 13.04.024, datë 7.10.2013, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸ Në shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2019, të DPSHTRR-së.

¹⁹ Pyetësor nr. 2, datë 18.7.2019.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2019, nga “A***” sh.p.k.

²¹ Shumë kjo e siguruar nga kredia në “Alpha Bank”, kontratë nr. *** datë 6.2.2014.

- mandatarkëtimi për shumën 3.400 euro, në datën 4.2.2015.
- Trupit gjykues, pas analizimit të akteve të administruara në dosjen e hetimit administrativ për këtë pasuri, si dhe pas kryerjes së analizës financiare, nuk i rezultuan problematika lidhur me përfitimin dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

5. Në lidhje me automjetin e tipit “Peugeot” (bashkëshorti), me targa ***, sipas kontratës datë 4.3.2016, me vlerë 6.700 euro. Burim të deklaruar krijimi: të ardhurat nga paga. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²².

ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja, nga shoqëria “A***” sh.p.k., dhe “Peugeot Albania”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti e ka deklaruar këtë automjet në deklaratën për vitin 2016, me përshkrim: automjet “Peugeot” (bashkëshorti), me targa ***, sipas kontratës, datë 4.3.2016, pagesë kësti në vitin 2016, në vlerën 2.300 euro, me burim krijimi të ardhura nga paga.

DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2019, konfirmon automjetin me targa ***, në pronësi të bashkëshortit të subjektit.

Kjo pasuri/automjet, konfirmohet me kontratën e shitjes nr. ***, datë 4.3.2016, nënshkruar mes shoqërisë “A***” sh.p.k., dhe bashkëshortit të subjektit, z. A.V., si dhe faturës tatimore²³ nr. ***, datë 4.3.2016, në vlerën 6.700 euro ose 925.136 lekë.

Nga aktet e administruara, në dosjen e hetimit administrativ, rezulton se me kontratën e datës 4.3.2016, bashkëshorti i subjektit, z. A. V., ka blerë nga shoqëria “A***” sh.p.k., automjetin e përdorur tip “Peugeot”, në vlerën 6.700 euro. Në kontratë është përcaktuar se blerësi do ta shlyejë këtë automjet për një periudhë trevjeçare, ku gjatë vitit të parë duhet të paguhej vlera 2.300 euro në një nga llogaritë e kompanisë “A***” sh.p.k.; gjatë vitit të dytë duhet të paguhej vlera prej 2.200 euro, po në një prej llogarive të kësaj kompanie; dhe në vitin të tretë të paguhej shuma prej 2.200 euro, në një nga llogaritë e shitësit, kompanisë “A***” sh.p.k.

Komisioni ka pyetur subjektin²⁴ dhe shoqërinë “A***” sh.p.k., mbi likuidimin e këtij automjeti.

Informacioni i dërguar nga subjekti përputhet me informacionin e dërguar nga shoqëria “A***” sh.p.k.²⁵

Komisionit i rezultoi se ky automjet është likuiduar, si më poshtë:

Tabela nr. 4

Derdhje <i>cash</i> në ISP, më 15.3.2016	1,300 euro
Derdhje <i>cash</i> në ISP, më 18.3.2016	1,000 euro
Derdhje <i>cash</i> në ISP, më 16.3.2017	270,000 lekë
Derdhje <i>cash</i> në ISP, më 11.5.2017	27,800 lekë
Derdhje <i>cash</i> në ISP, më 6.9.2018	278,000 lekë

²² Kontratë nr. ***, datë 4.3.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

²³ Në shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2019, të DPSHTRR-së.

²⁴ Pyetësor nr. 2, datë 18.7.2019.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2019, nga “A***” sh.p.k.

- Trupit gjykues, pas analizimit të akteve të administruara në dosjen e hetimit administrativ për këtë pasuri, si dhe pas kryerjes së analizës financiare, nuk i rezultuan problematika lidhur me përfitimin dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

Ndërsa, në lidhje me deklarinimin e subjektit në deklaratën për vitin 2016, nga verifikimi i saj, rezultoi dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime se:

- Dukej se subjekti kishte kryer deklarinim të pasaktë në deklaratën periodike të vitit 2016, pasi nuk kishte deklaruar vlerën e plotë të blerjes së automjetit (vlerën 6.700 euro), por kishte deklaruar vetëm pagesën e këstit të parë në vlerën 2.300 euro.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në lidhje me këtë konstatim, ndër të tjera, ka parashtruar se lidhur me blerjen e automjetit tip “Peugeot”, në vlerën 6.700 euro, mund të jemi para ndonjë pasaktësie në deklaratën e vitit 2016, por në thelb, vërtetësia e saj nuk ndryshon.

Subjekti është shprehur se burimet për krijimin e pasurive të deklaruara periodikisht dhe deklaratën “Vetting” burojnë vetëm nga të ardhurat nga paga me të cilat janë përballuar të gjitha shpenzimet për jetese dhe shlyerja e kredive. Gjithashtu, subjekti është shprehur se ka bërë deklarinim të saktë dhe korrekt në të gjitha deklarinimet e tij në përputhje me ligjin.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të dokumenteve të administruara gjatë hetimit administrativ dhe parashtrimit të subjektit se në këtë rast ka pasaktësi në deklaratën për vitin 2016, çmon se:

- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pasaktë në deklaratën periodike për vitin 2016, pasi nuk ka deklaruar vlerën 6.700 euro, e cilësuar në kontratë për blerjen e kësaj pasurie, por ka deklaruar vetëm këstin e paguar në këtë vit në vlerën 2.300 euro, fakt ky që nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

6. Në lidhje me gjendjen *cash* në vlerën 700.000 lekë, me burim të deklaruar krijimi: të ardhurat nga paga.

ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se: të ardhurat e realizuara mundësojnë krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Subjekti deklaron për herë të parë gjendje *cash* në deklaratën periodike të vitit 2006. Pas këtij viti ka vazhduar të deklarojë në mënyrë të rregullt gjendje *cash* deri në vitin 2016.

Komisioni kreu analizën mbi mundësinë e krijimit të kësaj gjendjeje *cash*, duke u bazuar në deklarinimet periodike të subjektit për shtesat dhe pakësimet për periudhën 2006 – 2016.

- Në përfundim të hetimit lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të gjendjes *cash*, si dhe pas kryerjes së analizës financiare, trupit gjykues i rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me mundësinë e krijimit të kësaj vlere.

DETYRIMET FINANCIARE

7. “Societe Generale Albania” (ish-Banka Popullore) Berat, konfirmon kredinë sipas kontratës së datës 27.7.2009. Detyrimi i pashlyer: në vlerën 368.974 lekë.

“OTP Bank” (ish-Societe Generale Albania), me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2019, konfirmon kredinë e marrë në datën 27.7.2009 dhe detyrimi i mbetur deri më 27.10.2016 është në vlerën 368.974,48 lekë.

- Trupit gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, i rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “OTP Bank”.

8. “Alpha Bank”, dega *** Tiranë, konfirmon kredi sipas kontratës shkurt 2014. Detyrimi i pashlyer: në shumën 371.472 lekë, si dhe 38,123 lekë interesa.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2018, “Alpha Bank”, konfirmon kredinë e vitit 2014 me kontratë nr. **, datë 6.2.2014, dhe detyrim i mbetur deri në datën 18.10.2016 është 371.471,82 lekë.

- Trupit gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, i rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Alpha Bank”.

9. Detyrim për shlyerje, në vlerën 4.000 euro, në momentin e hipotekimit të kontratës së sipërmarrjes me subjektin “A***” sh.p.k., me drejtues ligjor, z. G. I. D. .

Sipas mandatpagesave të depozituara nga subjekti, detyrimi i mbetur rezulton në vlerën 898.700 lekë. Nën arsyetimin e bërë në pasurinë nr. 3 më sipër dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti në prapësimet e saj, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- Deklarimi i subjektit përputhet për detyrimin e mbetur në vlerën 4.000 euro ndaj firmës “A***” sh.p.k.

10. Detyrim për shlyerje me subjektin “A***” sh.p.k., sipas kontratës, datë 4.3.2016, në vlerat:

- 2.200 euro viti 2017;
- 2.200 euro viti 2018.

Me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2019, shoqëria “A***” sh.p.k., konfirmon detyrimet sipas viteve përkatëse dhe shlyerjen e tyre.

- Trupit gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, i rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen ardhur nga shoqëria “A***” sh.p.k.

11. Kontratë me institutin “****”, për vitin shkollor 2016 – 2017, paguar vlera 60.000 lekë. Detyrimi i pashlyer në vlerën 138.000 lekë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2019, instituti “****” konfirmon kontratën për vitin shkollor 2016 – 2017 dhe vlerën prej 60.000 lekësh të paguar për këtë vit.

- Trupit gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar, i rezultoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e institutit “****”.

GJETJE TË TJERA GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

12. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard, ka deklaruar në lidhje me shpenzimet e arredimit të pasurisë, *apartament ndodhur në qytetin e Beratit, pasuria nr. 1, në këto rezultate*, se ato i përkasin periudhës 2002 – 2006, në vlerën 321.000 lekë, sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 5

1	Dhomë gjumi	60,000
2	Dhomë fëmijësh	35,000
3	Kuzhinë	50,000
4	2 divanë	22,000
5	Frigorifer	20,000
6	Lavatriçe	20,000

7	Televizor	24,000
8	Pormonto	15,000
9	Minibar	8,000
10	Sobë gatimi	13,000
11	Kondicioner	54,000
	Totali	321,000

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i dosjes së kredisë së marrë nga subjekti, në ish-Bankën Popullore²⁶ në vitin 2009, në vlerën 2.700.000 lekë, kredi kjo e përdorur për pasurinë nr. 3, në këto rezultate hetimi, Komisionit i rezultoi se në këtë praktikë subjekti kishte deklaruar për arredimin e kësaj shtëpie, shumat e pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 6

1	Dhomë gjumi	400,000
2	Dhomë fëmijësh	300,000
3	Kuzhina	400,000
4	Komplet kolltukë	300,000
5	Frigorifer	50,000
6	Lavatriçe	50,000
7	TV	80,000
8	Minibar	150,000
9	Kompjuter	100,000
10	Të tjera (piktura, porcelane etj.)	200,000
	Totali	2,030,000

Kjo shumë rezulton rreth 6.32 herë (2.030.000/321.000) më e lartë se sa ajo e deklaruar për Komisionin në pyetësin standard.

Komisioni e ka pyetur²⁷ subjektin për këto mospërputhje, por subjekti nuk ka dhënë sqarime për këtë pyetje. Subjekti është shprehur vetëm se sa ka shpenzuar për secilin vit nga 2002 – 2006, duke i qëndruar deklaramit të pyetësin standard.

Përpara këtij fakti, Komisioni vlerësoi që në analizën financiare të përfshijë kostot e deklaruara në bankë në vitin 2009, si kohë më e afërt me kryerjen e shpenzimit se sa ato të deklaruara në pyetësin standard. Gjithashtu, Komisioni i ka qëndruar ndarjes së shpenzimit të kryer për secilin vit të deklaruar nga subjekti, por duke e shumëzuar me 6.32, për të arritur shumën e shpenzuar për arredim sipas deklaramit të kryer në bankë.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2019, nga Societe Generale Albania Bank (ish-Banka Popullore, aktualisht OTP Bank), dosja e kredisë.

²⁷ Pyetësin nr. 2, datë 18.7.2019, pyetja nr. 15.

Komisionit, nga analiza e dokumentacionit arsyetuar si më sipër, i rezultoi dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën²⁸ e provës për të argumentuar dhe paraqitur prova, se:

- i. Dukej se kishte mospërputhje lidhur me deklarimin e subjektit për arredimin e pasurisë nr.1, se kishte shpenzuar vlerën 321.000 lekë në periudhën 2002 – 2006, me deklarimin e bërë në praktikën e kredisë (në vlerën 2.700.000 lekë) së përfituar për pasurinë nr. 3, se për arredimin e pasurisë nr. 1 kishte shpenzuar vlerën 2.030.000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera për këtë konstatim, ka parashtruar se: *“Është fakt se në asnjë rast kredimarrësit nuk përgatisin raportet bankare. Së dyti, në këto dokumente bankare nuk deklarohet asnjë dokument burimor i ofruar nga ana jonë si kredimarrës, apo ndonjë verifikim i bërë nga një specialist i bankës për gjendjen reale të pajisjeve shtëpiake, të paktën të thuhej nga intervistimi që u bëmë kredimarrësve. Ne për bankën ishim klientë 100 % të sigurt, pasi kishim të ardhura të mjaftueshme dhe kishim kolateral me vlerë tregu mbi dyfishin e shumës së marrë në bankë. As jemi intervistuar dhe as kemi deklaruar shifrat që gjenden në dokumentacionin e brendshëm të bankës. Dokumentacioni i dorëzuar dhe i nënshkruar nga ana jonë është tërësisht i verifikohem. Janë dorëzuar vërtetimet e pagave, gjendja gjyqësore, fotokopje të pasaportave. Për t’u sqaruar për këto shifra që përdorin specialistët e bankës i jemi drejtuar me shkresën nr *** prot., datë 14.11.2019, OTP Bank, dega Berat. I qëndrojmë deklarimit të bërë, se shuma e orendive për shtëpinë në Berat është në shumën 321.000 lekë, e shtrirë në periudhën 2002 – 2006. Duke korigjuar shifrat e vendosura për orendi dhe pajisje për vitet 2004-2005-2006, me shifrat e deklaruara, sqarohet problemi mbi aftësinë paguese për blerjen e makinës ‘Ford Fiesta’ dhe përballimi i shpenzimeve familjare, si dhe shlyerja e kredisë në këto vite”.*

Subjekti pretendon se shpenzimet e deklaruara prej saj janë korrekte dhe jo përgjigjet e ardhura nga bankat.

Gjithashtu, subjekti sqaron se nuk është pyetur dhe intervistuar asnjëherë nga banka, si dhe nuk ka qenë në dijeni të kësaj shume arredimi të cituar nga banka. Shkresat janë të njëanshme dhe të panënshkruara edhe nga punonjësi.

Subjekti ka depozituar përgjigjen me nr. *** prot., datë 21.11.2019, nga “OTP Bank”.

Vlerësimi i Komisionit

- Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit se shpenzimet e kryera për arredimin e pasurisë në qytetin e Beratit kanë qenë në shumën 321.000 lekë dhe jo në shumën 2.030.000 lekë, nuk qëndrojnë për disa arsye:

- Subjekti, shumën e pretenduar për arredimin e kësaj pasurie e ka deklaruar në pyetësorin standard.

- Gjatë hetimit administrativ, Komisioni analizoi burimin e ligjshëm të pasurisë nr. 3 të pasqyruar dhe arsyetuar më sipër. Ndër të tjera, si burim i kësaj pasurie ishte përdorur edhe një kredi në vlerën 2.700.000 lekë, e marrë në “OTP Bank”.

- Gjatë verifikimit të praktikës bankare ka konstatuar se për përfitimin e kësaj kredie ishte administruar edhe pasqyra e orendive shtëpiake e pasurisë në qytetin e Beratit, si garanci për përfitimin e kredisë bankare. Pasqyra e orendive thuhet evidentonte të njëjtat orendi shtëpiake që subjekti ka cilësuar në pyetësorin standard, por shuma e shpenzuar për blerjen e pasurive,

²⁸ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

thënë ndryshe, shuma e arredimit të pasurisë, reflektohet disa herë më e lartë nga ajo e pretenduar.

- Megjithëse subjekti i ka qëndruar deklarimit të saj për shpenzimet e kryera, nuk arriti të depozitonte ndonjë dokument provues të çmimeve referente të orendive shtëpiake për kohën në të cilën është kryer arredimi i pasurisë, të faturave, të mandatpagesave, apo prova të tjera të tërthorta që të mbështeste pretendimin e saj.

Trupi gjykues, lidhur me përlogaritjet e vlerës së shpenzuar për arredimin e kësaj pasurie, është bazuar në faktet dhe provat e dala nga hetimi administrativ, si dhe ka krijuar bindjen e tij mbi këto fakte, duke mos pranuar kërkesën e subjektit për të këqyrur apartamentin, për shkak se vlerësimi i orendive shtëpiake nuk do të ishte objektiv, për sa kohë ky arredim është kryer thujtë 13 vjet përpara, sipas deklarimit të vetë subjektit rivlerësues, si dhe për sa arsyetohet në vijim.

- Nisur nga informacioni i dhënë nga "OTP Bank", ku citohet se shuma e pasqyruar për blerjen e orendive mund të jetë reflektuar ose nëpërmjet intervistimit të bërë me klientin, që në këtë rast është përfituesi i kredisë, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe subjekti, ose është cilësuar nga punonjësi i bankës sipas çmimeve të tregut, mbështet faktin që shpenzimi për arredimin e pasurisë është në vlerën 2.030.000 lekë, për arsye se në secilin rast pasojë është e evidente dhe konfirmon këtë shumë.

Më konkretisht, nëse marrim të mirëqenë se subjekti është intervistuar atëherë, orenditë janë po të njëjta dhe vlera është pranuar nga i intervistuari dhe, për pasojë, shuma është thjesht dhe vetëm përlogaritje totale. Po ashtu, kjo nënkupton dijeni të plotë të subjektit për shumën, fakt i cili bie në kundërshtim me pretendimin e subjektit mbi një tjetër shumë. Nëse marrim të mirëqenë pretendimin tjetër të subjektit se nuk është intervistuar, atëherë qëndron varianti tjetër, sikurse vetë banka jep dy alternativa në këtë çështje, se vlerësimi është bërë nga një punonjës i saj sipas çmimeve të tregut, çka jo vetëm konfirmon vlerën 2.030.000 lekë nga njëra anë, por nga ana tjetër reflekton edhe faktin se sa kanë qenë vlerat e orendive në atë vit, që për nga përlogaritjet kohore me vitet e pretenduara nga subjekti se ka arreduar shtëpinë deri në vitin 2006, nuk duket të kenë qenë të largëta, çka përforcon provueshmërinë e shumës.

Po ashtu, trupi gjykues konstaton se banka në përgjigjen e saj nuk përjashton në asnjë moment, apo nuk vë në dyshim vlerën e shpenzuar për blerjen e orendive, por thjesht dhe vetëm rikonfirmon atë/shumën në të dy alternativat që mendohet se është deklaruar. Një fakt mbetet i pandryshueshëm në këtë arsyetim, se cilësimi i orendive duket të jetë i pamundur të ideohet dhe përcaktohet nga një punonjës banke, në raport me zotëruesin e vërtetë të orendive, që në këtë rast janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

Në tërësi të këtij arsyetimi, përlogaritjet e shpenzimeve për arredimin e pasurisë të kryera përgjatë viteve 2002 - 2006, sikundër ka deklaruar subjekti, kanë prekur në vite të ndryshme brenda kësaj periudhe analizën financiare dhe, për pasojë, subjekti ka rezultuar në balancë negative në vitin 2005, sikurse ka rezultuar në pikën 13 (në rezultatet e hetimit administrativ) dhe po ashtu edhe në vitin 2006, sikurse është arsyetuar më sipër në pikën 2.

Nën këtë arsyetim, trupi gjykues i ka qëndruar këtij vlerësimi edhe për sa kohë, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokument justifikues, për të provuar vlerën reale të shpenzimit të arredimit të pasurisë sipas pretendimit të saj, krahasuar me vlerën disa herë më të lartë të deklaruar apo shënuar nga punonjës të bankës në praktikën bankare.

Baza ligjore

Trupi gjykues, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaronet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për arredimin e pasurisë së ndodhur në qytetin e Beratit, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, Komisionit, nga analiza financiare e kryer për vitet 2004 - 2016²⁹, i ka rezultuar dhe, për pasojë, i ka kaluar subjektit barrën³⁰ e provës për të argumentuar dhe paraqitur prova se:

- Dukej se nuk kishte pasur mundësi financiare në vlerën 314.272 lekë në vitin 2005 dhe në vlerën 82.051 lekë në vitin 2012, për të përballuar shpenzimet familjare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në parashtrimet e saj, pretendon se shpenzimet e *TIMS*-it për vitin 2012 janë marrë më të larta se sa ato që ajo shpenzuar realisht. Sipas subjektit shpenzimet për të gjithë familjen kanë qenë 30 euro/nata për akomodim dhe 50 euro/dita për ushqim, duke shtuar edhe faktin se ka gatuar në ambientin e marrë me qira gjatë kohës së pushimeve.

Subjekti pretendon se shpenzimet për pushime (328.342 lekë) nuk mund të zënë 58.2 % të shpenzimeve vjetore për jetesë (564.096 lekë).

Për udhëtimin e vitit 2006, konkretisht 24.8.2006 – 27.8.2006, subjekti deklaron se bashkëshorti ka udhëtuar për qëllime pune në Stamboll, Turqi.

Vlerësimi i Komisionit

- Trupi gjykues, lidhur me mungesën financiare të subjektit për të përballuar shpenzimet familjare për vitin 2005, në vlerën 314.272 lekë, ka arsyetuar pasojën e ardhur si rezultat i shpenzimeve për arredimin e pasurisë në qytetin e Beratit, duke çmuar në përfundim se kjo diferencë mbetet e pandryshueshme.

- Po ashtu, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se shpenzimet e *TIMS*-it për vitin 2012 janë marrë më të larta se sa ato që ajo shpenzuar realisht, nuk qëndron, për faktin se përlllogaritjet financiare të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor janë bazuar në praktikën e unifikuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit³¹, sipas të cilës shpenzimet ditore për person janë 50 euro për të rritur dhe 25 euro për fëmijët nga 5-18 vjeç.

- Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se edhe pretendimi tjetër i subjektit se shpenzimet për pushime (328.342 lekë) nuk mund të zënë 58.2% të shpenzimeve vjetore për jetesë (564.096 lekë), nuk qëndron për faktin se shpenzimet e jetesës mbi të cilat kryhet analiza financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor, janë shpenzime minimale jetike dhe kështu nuk tregojnë standardin real të jetesës.

- Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit se bashkëshorti i saj ka udhëtuar nga data 24.8.2006 – 27.8.2006, për qëllime pune në Stamboll, Turqi, nuk qëndron, për sa kohë pretendimi mbeti vetëm në nivel deklarativ i paprovuar me dokumentacion justifikues për të kuptuar se kush ka qenë mbuluesi i shpenzimeve të bëra.

- Për sa më sipër, trupi gjykues, arrin në konkluzion se:

- Subjekti i rivlerësimit ka mungesë financiare në vlerën 314.272 lekë në vitin 2005 dhe në vlerën 82.051 lekë në vitin 2012, për të përballuar shpenzimet familjare.

²⁹ Balancat negative për vitet 2004 dhe 2006 janë sqaruar dhe pasqyruar në pasuritë e mësipërme.

³⁰ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

³¹ Referojuni vendimit nr. 11, datë 22.5.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Edmond Islamaj. <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/07/E-Islamaj-vendim-i-anonimizuar-p%C3%ABr-web.pdf>

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 31.7.2019, ku ka konstatuar se:

- Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani.

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; rezultoi se ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën; si dhe nuk rezultoi të ketë bërë deklarime të pasakta, ose të ketë fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: formularin e vetëdeklarimit; tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; të dhënat dhe dokumentet që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

Në raport janë përshkruar gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit të subjektit, si dhe dokumentet e depozituara prej tij. Po ashtu, janë përshkruar detyrat e kryera, trajnimet e përfituara, etj (për më shumë, referohuni në raportin përkatës). Ndër të tjera, raporti në analizën e gjetjeve ka konstatuar si vijon:

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, ka aftësi mesatare në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Marjana Velçani kualifikon drejt marrëdhënien juridike, objekt shqyrtimi gjyqësor (shihni dosjet 2, 4 dhe 5). Analizon nga pikëpamja ligjore aktin administrativ dhe arsyeton rastin kur ai është absolutisht i pavlefshëm nëpërmjet argumenteve ligjore (shihni dosjen 2). Kur është rasti, përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre (shihni dosjet 2 dhe 3), apo ligjin e hershëm në kohë (shihni dokumentin 3). Gjyqtarja shfaq probleme në drejtim të procedurës së parashikuar nga ligji nr. 49/2012.

Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuri mesatare në të drejtën administrative.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Në përgjithësi, nuk përdor referenca në jurisprudencën e gjykatave më të larta, me përjashtim të një rasti që lidhej me marrëdhëniet e punës (shihni dosjen 5).

Vendimet gjyqësore të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, paraqiten të standardizuara në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në interpretim të gërmës “c”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Nga të dhënat statistikore të gjyqtarës Marjana Velçani konstatohet lehtësisht se ajo ka pasur ngarkesë sasiore tepër të lartë, pothuajse trefishin e standardit minimal.

Në analizë të të dhënave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, është pjesërisht efeciente dhe efektive. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së saj ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore tepër e lartë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjyqtarja Marjana Velçani, në lidhje me procedurën e gjykimit të ndjekur në pesë dosjet e vëzhguara, ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme. Në katër çështje, që i përkasin viteve 2013 - 2015, gjyqtarja ka zbatuar procedurën e gjykimit të çështjeve civile, duke mos ndjekur veprimet e përcaktuara përgatitore nga neni 25, i ligjit nr. 49/2012 (shihni dosjet 1, 2, 3 dhe 4). Ndërsa, në çështjen e fundit, që i përket vitit 2016, gjyqtarja ka ndryshuar qëndrimin e mësipërm, duke zhvilluar veprime përgatitore në përputhje me procedurën e parashikuar nga neni 25, i ligjit nr. 49/2012 (shihni dosjen 5). Ajo nuk i kushton rëndësi afatit 7-ditor të caktuar nga ligji për vënien

në lëvizje të çështjes gjyqësore, ndërsa në një rast veprimet përgatitore nuk tregojnë datën e kryerjes së tyre (shihni dosjen 5). Është konstatuar një rast kur seanca gjyqësore është caktuar përtej afatit 15-ditor të parashikuar nga pika 1, e nenit 27, e ligjit nr. 49/20012 (shihni dosjen 2). Po ashtu, janë konstatuar dy raste kur seanca e diskutimit përfundimtar është caktuar në tejkalim të afatit 5-ditor (shihni dosjet 3 dhe 4). Nisur nga fakti që tejkalimi i afatit është me 1-2 ditë, konkludohet që ky tejkalim lidhet me pakujdesinë e gjyqtarës ndaj afateve. Ky konkluzion forcohet edhe nga një rast tjetër, ku është konstatuar se seanca gjyqësore është shtyrë pas 2 muajve e 14 ditëve (shihni dosjen 5).

Gjyqtarja nuk i kushton rëndësinë e duhur dokumentimit të veprimeve të kryera, si dhe nuk shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme gjatë gjykimit. Të tilla janë rastet për zhvillimin e gjykimit në mungesë, për thirrjen e Avokaturës së Shtetit në gjykim, apo për ndryshimet e objektit të padisë (shihni dosjet 2 dhe 3).

Në pesë çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 2 seanca (shihni dosjen 1), me 7 seanca (shihni dosjen 2), me 9 seanca (shihni dosjen 3), me 5 seanca (shihni dosjen 4) dhe me 4 seanca (shihni dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 27 seanca, nga të cilat 18 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 9 seanca joproduktive është bërë kërkesa e përfaqësueses së paditësit për të saktësuar objektin e padisë dhe për të paraqitur provat (1 seancë), mungesa e paditësit (1 seancë), njoftimi i parregullt i palëve (5 seanca), kërkesa e të paditurit për shtyrjen e seancës (1 seancë) dhe mungesa e gjyqtarës për arsye shëndetësore (1 seancë). Konstatohet një numër i lartë seancash të dështuara për shkak të njoftimit, edhe kur pala është organ publik me adresë të mirëpërcaktuar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Në katër raste, në dosje nuk është përfshirë akti formal, me të cilin gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjen gjyqësore (shihni dosjet 1, 2, 3 dhe 4). Në një rast tjetër, veprimet përgatitore në dhomë këshillimi janë dokumentuar me procesverbal, por data e tyre nuk është shënuar (shihni dosjen 5). Ndërsa në një rast tjetër, në vendimin e ndërmjetëm për caktimin e seancës së radhës, ka gabim në datën e seancës (shihni dosjen 2). Aktet gjyqësore të tjera janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Marjana Velçani (shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së). Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, nuk ka respektuar rregullat procedurale, që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Marjana Velçani për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Vlen të theksohet se pesë dosjet e vëzhguara janë gjykuar prej saj në cilësinë e gjyqtarës së vetme.

RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisionit, sikurse është shprehur edhe KLD-ja, në raportin e tij të vlerësimit profesional i kanë rezultuar³² në tetë dosjet, përkatësisht, tri dosjet e përzgjedhura nga vetë subjekti dhe pesë dosjet e shortuara, problematika të natyrës procedurale për sa i përket:

- tejkalimit të kohëzgjatjes së gjykimit përtej standardit 1-mujor, përcaktuar nga germa “c”, e pikës 5, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit³³;
- dorëzimit të dosjeve në sekretari në shkelje të afatit 7-ditor, të përcaktuar nga pika 3, e nenit 42, e ligjit nr. 49/2012;
- respektimit të afatit kohor 7-ditor, të parashikuar nga pika 1, e nenit 25, e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit ka vënë në lëvizje çështjen, por pa nxjerrë një akt formal, vendim apo urdhër për planifikimin e veprimeve përgatitore;
- caktimit të seancave gjyqësore në tejkalim të afatit 15-ditor, të parashikuar nga pika 1, e nenit 27, e ligjit nr. 49/2012; si dhe
- gjykimit të procesit gjyqësor, pa u regjistruar në audio.

Komisionit, nga aktet e administruara në raportin e vlerësimit profesional, i ka rezultuar se në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar gjashtë prej tyre. Në katër raste, vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit (shihni dokumentet 1, 2 dhe 3, si dhe dosjet 2 dhe 4). Në dy raste të tjera, Gjykata Administrative e Apelit nuk është shprehur ende me vendim mbi ankimin e palëve (shihni dosjet 3 dhe 5).

Nga të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së ka rezultuar se janë paraqitur gjithsej gjashtë ankesa në Inspektoratin e KLD-së. Katër ankesa (1 e vitit 2015 dhe 3 të vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, ndërsa një ankesë e vitit 2014, e verifikuar për mosrespektim formal ligji, është mbajtur në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta, ndërsa një ankesë e vitit 2015, e verifikuar për zvarritje gjykimi, i është regjistruar subjektit për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Marjana Velçani, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Për sa më sipër analizuar, lidhur me dosjet e rivlerësuara për kriterin profesional, si dhe bazuar në pikën 2, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: *aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore*” dhe në pikën 3 të po këtij neni: *aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u*

³² I gjeni me të dhëna të plota të dosjeve në Aneksin nr. 2 dhe nr. 3, në formë narrative dhe tabelave.

³³ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin 1 “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

bazuar në treguesit ... duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime³⁴.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, në tërësi në parashtrimet e saj, ka pretenduar se ka pasur ngarkesë të lartë pune, pra, ka pasur volum të dosjeve gjyqësore. Subjekti ka parashtruar se në tërësi vendimet e saj kanë mbetur në fuqi, duke e pasqyruar këtë fakt si një tregues pozitiv të punës së saj. Po ashtu, ka parashtruar se nëse do të zbatonte procedurën e parashikuar në nenin 25/1, të ligjit nr. 49/2012, do të ishte tepër e vështirë që në tërësinë e dosjeve, të një volumi tërësisht të madh të tyre, të mund të gjejë dosjen, ta identifikojë në radhën ku e kishte vendosur, për të vazhduar më pas me procedurën, apo edhe për faktin se dosjet nuk ishin të regjistruara në sistem. Gjykata administrative ka sqaruar se subjekti ishte në fillimet e para, duke u përballur me një pafundësi dosjesh, me mungesë të bazës materiale, të ambienteve të punës, të mungesës së eksperiencës, të mungesës dhe të stafit, të ftuesit të gjykatës, që si fillim e kishte të pamundur të realizonte njoftimin me anë të fletëthirrjeve për çështjet në gjykim. Subjekti ka pranuar moszbatimin e procedurës administrative për shkak të ngarkesës së pafundme të dosjeve dhe, për pasojë, të situatave jo normale të punës.

Subjekti ka qartësuar se palëve në gjykim nuk i ka mohuar të drejtat e tyre procedurale dhe se ka dhënë vendime të drejta, ligjore dhe të paanshme, pavarësisht ngarkesës së lartë, për të cilën është munduar ta ulë, duke gjykuar drejt dhe shpejt. Ka theksuar se është vlerësuar dy herë shumë mirë nga KLD-ja, sot KLGJ.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në tërësi për konstatimet e rivlerësimit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit, me gjithë pretendimet e paraqitura nga ky i fundit, konstaton se nga njëra anë ato nuk qëndrojnë dhe nuk përkojnë me rolin dhe punën e një gjyqtari, por nga ana tjetër vlerëson ngarkesën dhe disa vështirësi në ngritjen dhe mirëfunksionimin e institucioneve të reja, siç është edhe rasti i gjykatave administrative.

Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit se moszbatimi i procedurës në zhvillimin e proceseve gjyqësore, sipas ligjit nr. 49/2012, lidhet edhe me ngarkesën apo volumin e lartë të dosjeve gjyqësore për shqyrtim, nuk qëndron, për vetë faktin se hartimi i akteve procedurale në të dy rastet e shqyrtimit gjyqësor, më konkretisht, në rastin e gjykimit të çështjeve civile dhe po ashtu edhe në rastin e gjykimit të çështjeve administrative, merr kohën e nevojshme për njoftim të palëve ndërgjyqëse, për depozitim të prapësimeve në padi, për kalim dhe shqyrtim të çështjeve në seancë përgatitore dhe gjyqësore, për kalim të çështjes në dhomë këshillimi, për dokumentim të veprimeve përgatitore, e me radhë, sipas legjislacioneve përkatëse civile apo administrative, veprime të cilat sipas legjislacionit administrativ janë vlerësuar më të shpejta dhe më dobiprurëse për palët ndërgjyqëse, dhe që në këtë këndvështrim pretendimi se është

³⁴ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 2, të nenit E të Kushtetutës.

zbatuar neni 158/1 i Kodit të Procedurës Civile (veprime përgatitore të kryera sipas kësaj procedure në dosjet 1³⁵, 2³⁶, 3³⁷ dhe 4³⁸), si mënyrë më e thjeshtuar, nuk qëndron.

Trupi gjykues ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka zbatuar me përpikëri procedurën e parashikuar nga ligjin nr. 49/2012 në dosjen nr. 5, e cila është shqyrtuar në vitin 2016, kohë në të cilën sipas raportit të KLGJ-së subjekti rezultoi të ketë pasur numër më të lartë të çështjeve gjyqësore për gjykim, krahasuar me ato të viteve 2014 dhe 2015. Moszbatimi i procedurës specifike nga subjekti i rivlerësimit, sipas germës “ç”, të pikës 1, të nenit 25, të ligjit nr. 49/2012, gjatë shqyrtimit të një procesi gjyqësor, nga trupi gjykues, në analizë të secilës dosje gjyqësore, por edhe të metodës krahasimore, nuk çmohet si paaftësi profesionale e subjektit, por si neglizhencë e veprimtarisë së punës së saj, për shkak se duket që subjekti ka vijuar të ndjekë rutinën e mëparshme të veprimtarisë së punës së saj si gjyqtare në çështjet civile.

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk kundërshtoi me akte provuese mungesën në aktet e administruara në dosjet gjyqësore të shortuara (dosjet 4 dhe 5³⁹) të vendimmarrjeve të ndërmjetme për kalime në seancë, etj. Në këtë rast subjekti nuk depozitoi procesverbale të cilat, në përmbajtje të tyre, të pasqyronin edhe vendimmarrjet e ndërmjetme, apo edhe vendime të kësaj natyre.

Trupi gjykues vlerëson se edhe konstatimet e tjera gjatë hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve⁴⁰ në tejkallim të afatit 1-mujor në dosjet e shortuara, lidhur me caktimin e seancave gjyqësore në tejkallim të afatit (dosja 2 dhe 5) të parashikuar në pikën 1, të nenit 27, të ligjit nr. 49/2012, lidhen me aftësitë organizative të subjektit, thënë ndryshe, me menaxhimin e veprimtarisë së punës së saj, apo edhe me aftësinë për të administruar siç duhet dosjet gjyqësore.

- Trupi gjykues çmon se në tërësi konstatohen parregullsi në dosjet gjyqësore mbi të cilat është vlerësuar dhe rivlerësuar profesionalisht subjekti i rivlerësimit, por duke konsideruar: (i) ngarkesën e çështjeve që subjekti i rivlerësimit ka pasur përgjatë ushtrimit të funksionit të saj në gjykatën administrative; (ii) vështirësitë e hasura në ngritjen dhe mirëfunksionimin e institucioneve të reja, siç është edhe rasti i gjykatave administrative, si dhe (iii) faktin e rezultuar se në vitin 2016, në ndryshim nga vitet e mëparshme, në gjykimin e çështjeve ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 49/2012 (më konkretisht, dokumentuar në dosjen 5, si një ndër dosjet e shortuara) lidhur me ndjekjen e veprimeve procedurale, proporcionalisht, çmon se me parregullsitë e konstatuara nuk mund të arrihet në një konkluzion për mospërbushje të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

³⁵ Çështja administrative nr. *** regj., datë 24.2.2014 regjistrimi, që i përket paditëses M. M. kundër të paditurit, Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë Durrës, me objekt “regjistrimi i detyruar i një fëmije të seksit mashkull në regjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile, Durrës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 2.4.2014.

³⁶ Çështja administrative nr. ***regj., datë 9.1.2014 regjistrimi, që i përket paditësit Prefekti i Qarkut Tiranë kundër të paditurit I. D. dhe personit të tretë, ZVRPP-së Kavajë, me objekt “shfuqizimin e plotë të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. ***, datë 7.10.2002, në emër të të paditurit dhe detyrimin për të paguar vlerën e tokës prej 362.000 lekësh”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.5.2014.

³⁷ Çështja administrative nr. *** regjistri themeltar, datë 6.2.2015 regjistrimi, që i përket paditësit, shoqëria “I*** ” sh.p.k., kundër të paditurve, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor, me objekt “shfuqizimin e akt-konstatimit nr. ***, datë 15.7.2014, të njoftimit të vlerësimit për detyrimet nr. *** prot., datë 17.9.2014 dhe të vendimit nr. *** prot., datë 8.1.2015, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë”, e përfunduar me vendimin nr.***, datë 19.6.2015.

³⁸ Çështja administrative nr.*** regj. them., datë 11.3.2015 regjistrimi, që i përket paditësit I. K. kundër të paditurve Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë dhe IEVP-së Peqin, me objekt “anulimin e urdhrit nr. ***, datë 9.1.2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, anulimin e urdhrit nr. ***, datë 16.1.2015 të IEVP-së Peqin, detyrimin për pagesën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe kthimin në punë”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.6.2015.

³⁹ Çështja gjyqësore nr.*** regjistri them., datë 13.5.2016 regjistrimi, që i përket paditëses S. Gj. kundër të paditurit Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan, me objekt “shpërbllim dëmi me 2 paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit, me 2 paga mujore për mosrespektim të procedurës, me 7 paga mujore për vjetërsi në punë dhe me 12 paga mujore për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës”, e përfunduar me vendimin nr.***, datë 7.10.2016.

⁴⁰ Shkak për tejkallimin e afatit standard në 4 çështje është bërë organizimi i punës, mosrespektimi i procedurës dhe ngarkesa e lartë sasiore që ka pasur gjyqtarja.

Denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur gjashtë denoncime nga shtetas të ndryshëm, si më poshtë vijon:

1. Nga denoncimet⁴¹ e shtetasve R. D., Xh. M., B.T., M. K., nga analizimi i ankimeve dhe akteve shoqëruese të tyre, konstatohet se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte, apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.
2. Ndërsa, në lidhje me denoncimin⁴² e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, denoncuesi, në ankimin e tij, ka parashtruar se subjekti i rivlerësimit, në vendimin e themelit nr. ***, datë 4.12.2018, të dhënë për pranimin e pjesës së padisë, me palë paditëse subjektin tregtar “Xh***” sh.p.k., dhe palë të paditur, Këshillin e Basenit Ujor Shkumbin, ndër të tjera, ka vendosur edhe ekzekutimin e përkohshëm të tij. Ankuesit pretendojnë se ndaj vendimit të ekzekutimit të përkohshëm kanë ushtruar ankim të veçantë brenda pesë ditëve, sikurse parashikohet në nenin 318 të Kodit të Procedurës Civile. Nga verifikimet që kanë kryer, ankuesit parashirojnë dhe pretendojnë se, pavarësisht se kanë kaluar 7 muaj nga paraqitja e ankimit ndaj këtij vendimi, dosjet gjyqësore mbi të cilat është marrë vendimi nuk rezultojnë të jenë dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit, në kundërshtim me nenin 48, të ligjit nr. 49/2012. Ata pretendojnë se ekzekutimi i përkohshëm ka shkaktuar pasoja të rënda për mjedisin, në dëm të interesit publik, shkak i të cilës mund të jetë dalja e lumit Shkumbin nga shtrati, duke shkaktuar dëme në tokat bujqësore dhe në njerëz.

Për sa më sipër analizuar, si dhe bazuar në pikën 2, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: *aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore*, në pikën 3 të po këtij neni: *aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit ... duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit*, Komisioni i kërkoi⁴³ subjektit të japë shpjegime mbi shkaqet që kanë sjellë vonesën e dërgimit të dosjes në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në vijim të analizimit të dokumentacionit shoqërues të këtij denoncimi, Komisioni, nga arsyetimi i vendimit, ka konstatuar se:

- Nisur nga parashikimet e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, dukej se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimit, nuk ka pasqyruar dhe arsyetuar mbi prova konkrete mbi të cilën është bazuar dhe është bindur për të arritur në dhënien e një vendimi me ekzekutim të menjëhershëm në favor të paditësit.

Neni 317 i Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar rastet e dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, ku më konkretisht në të thuhet: *Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur: a) ...; b) ...; c) ...*

Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci.

Kundër vendimit me të cilin pranohet ose rrëzohet kërkesa për ekzekutim të përkohshëm të vendimit, mund të bëhet ankim i veçantë.

Gjithashtu, mbi këto parashikime, si dhe në bazë të pikës 2, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: *njohuritë ligjore do*

⁴¹ Nr. *** prot., datë 7.12.2017, në dosjen e Komisionit.

⁴² Nr. *** prot., datë 5.8.2019, në dosjen e Komisionit; nr.*** prot., datë 7.3.2018, në dosjen e Komisionit; nr. *** prot., datë 17.10.2018, në dosjen e Komisionit; nr. ***prot., datë 30.5.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴³ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

të vlerësohen ... sipas treguesve si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën dhe pikës 3 të po të njëjtit nen: aspekti i arsytimit ligjor .. do të vlerësohet sipas treguesve si kuptueshmëria e vendimit dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte arsytuar në vendimmarrjen e saj mbi moskërkimin e dhënies së garancisë nga paditësi, por ishte mjaftuar vetëm me vlerësimin e pasojave që mund t'i vijnë paditësit dhe të punësuarve të tij nga vendimmarrjet e institucionit shtetëror dhe, për pasojë, i kërkoi⁴⁴ subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se: *“Në lidhje me padinë ku pala paditëse është subjekti tregtar “Xh***”, sh.p.k., kam vendosur dhe ekzekutimin e përkohshëm, si dhe kam konstatuar se akti i nxjerrë prej të paditurës është jo i drejtë, jo ligjor, pavarësisht faktit se kam vendosur detyrimin e organit publik, palë e paditur në gjykim, të rishikojë aktin e nxjerrë prej saj. Kam çmuar që vendimin ta jap me ekzekutim të përkohshëm, kërkesë kjo e palës paditëse në gjykim. Në lidhje me këtë moment jam shprehur: Në lidhje me kërkimin e palës paditëse për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas parashikimeve të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata çmon se neni 317/2 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: ‘Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci’”.*

Siç përcaktohet në këtë parashikim ligjor, çdo vendim gjyqësor mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, duke u nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, kur nga vonesa e ekzekutimit pala paditëse pëson humbje që nuk mund të vihen në vend, ose kur vendimi i ekzekutimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në rastin konkret, palës paditëse i është miratuar një leje me afat, një pjesë e këtij afati ka kaluar duke përfshirë edhe periudhën nga dalja e vendimit të palës së paditur për shfuqizimin e saj deri sot. Për zbatimin e lejes për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin, pala paditëse ka kryer shpenzime në fuqi punëtore dhe materiale, të cilat me kalimin e kohës, në rast ankimit të këtij vendimi nga pala e paditur, do të kalonin në inefficiencë, gjë që do ta vështirësoonte së tepërmi ekzekutimin e këtij vendimi të dhënë në favor të saj, si palë paditëse. Subjekti është shprehur se nuk ka çmuar që paditësi të jepte garanci, pasi kjo është në çmim të gjykatës, kërkesë të cilën e shqyrton rast pas rasti.

Subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2019, shkresën nr. *** regj., datë 16.10.2019, si dhe shkresën nr. *** regj., datë 18.11.2019.

Vlerësimi i Komisionit

- Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të institucionit publik se mbi ankimin e veçantë ndaj ekzekutimit të përkohshëm të menjëhershëm të dhënë nga subjekti në vendimmarrjen e shkallës së parë, është tejkalluar afati i dërgimit të dosjes pranë Gjykatës Administrative të Apelit, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar ankimin me nr. ***regj, datë 18.11.2019, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me të cilën rezulton se është dërguar dosja gjyqësore, objekt i këtij denoncimi.
- Në vijim, lidhur me ekzekutimin e përkohshëm të dhënë nga subjekti, trupi gjykues, në analizë të fakteve të konstatuara dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit *se çdo vendim gjyqësor mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, duke u nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, kur nga vonesa e ekzekutimit pala paditëse pëson humbje që nuk mund të vihen në vend, ose kur vendimi i ekzekutimit do të bëhej i pamundur, ose do të*

⁴⁴ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në pikën 2, të nenit E, të Kushtetutës.

vështirësohej së tepërmi, konstaton se në tërësi pretendimi nuk qëndron. Në këto raste ligjvënësi e lidh ngushtësisht miratimin e ekzekutimit të përkohshëm me vonesën e marrjes së vendimit të formës së prerë, pra, thënë ndryshe, i paraprin vendimit të formës së prerë derisa ai të bëhet i tillë. Në çështjet administrative vonesa në vendimmarrjen e formës së prerë nuk mund të jetë argument apo shkak për marrjen e ekzekutimit të përkohshëm, për shkak se në këto çështje procedohet në afate kohore të shkurtra, në ndryshim nga zhvillimi i proceseve civile. Pra, mundësia më e madhe e subjektit për të argumentuar ekzekutimin e përkohshëm duket të ketë qenë vendosja e garancisë, procedurë e cila nuk rezulton të jetë ndjekur nga subjekti.

- Nga ana tjetër, subjekti do të duhet të kishte arsyetuar qartë dhe plotësisht edhe mbi faktin nëse ekzekutimi i vendimit të formës së prerë do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi, apo edhe në tërësi të argumentonte se cilat do të ishin pasojat e pariparueshme, të cilat çuan gjykatën në këtë vendimmarrje të shpejtë.
- Gjithashtu, trupi gjykues çmon se, për sa kohë pretendohet nga pala e paditur se mund të cenohej interesi i publikut, në rastin konkret të banorëve pranë shtëpive të të cilëve edhe po punohej nga pala paditëse, i cili konkurrin në raport me interesin e palës paditëse, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte argumentuar bindshëm se përse nuk ka vlerësuar dhënien e garancisë nga pala paditëse, duke mbajtur në vëmendje edhe dëmet që mund të shkaktoheshin nga vazhdimi i punimeve, pasojat që mund t'u vinin banorëve, dëmi i shkaktuar ndaj këtyre të fundit që mund të kërkohej të shpërblehej gjyqësisht.

Shtetasi S. B. në denoncimin dhe në parashtrimet e tij ankohet ndaj vendimmarrjes së padrejtë të subjektit të rivlerësimit, për shkak të pretendimit të tij për të qenë palë ndërgjyqëse, ndërsa nuk është pranuar. Në dokumentet bashkëngjitur është administruar vendimi nr. ***, datë 3.2.2015, marrë nga subjekti i rivlerësimit, i cili është lënë në fuqi në gjykatat e shkallëve më të larta. Nga verifikimi nuk rezulton që në këtë vendim denoncuesi të jetë me cilësinë e palës ndërgjyqëse.

Komisionit, nga arsyetimi i vendimit të subjektit të rivlerësimit, i rezultoi se dukej se:

- Subjekti i rivlerësimit, rast pas rasti, përmend shtetasin S. B., pasqyron pozitën e këtij të fundit lidhur me ndërtimin që ka bërë, pasqyron mbi veprime të ndërmarra nga KRRT-ja, Bashkia Elbasan, ndaj lejes së ndërtimit të dhënë këtij shtetasi, pa e pasur në cilësinë e palës ndërgjyqëse. Subjekti nuk rezulton të ketë arsyetuar mbi kërkimin e denoncuesit për pjesëmarrje në gjykim dhe mospranimin e kërimit.

Për sa më sipër analizuar, si dhe bazuar në pikën 2, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë": *njohuritë ligjore do të vlerësohen ... sipas treguesve si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën dhe parashikimit të pikës 3 të po të njëjtit nen: aspekti i arsyetimit ligjor .. do të vlerësohet sipas treguesve si kuptueshmëria e vendimit dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik dhe, për pasojë, Komisioni i kërkoj⁴⁵ subjektit të japë shpjegime.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti ka parashtruar në prapësimet e saj se kjo çështje lidhet me vendimin nr. ***, datë 3.2.2015, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Administrativ me vendimin nr. ***, datë 23.4.2015, si dhe nga Gjykata e Lartë.

Subjekti ka sqaruar se objekti i padisë ka qenë anulimi i vendimit nr. ***, datë 12.11.2014, akt ky i nxjerrë nga i padituri (IKMT). Në një situatë të tillë subjekti ka sqaruar se nuk mund

⁴⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikën 2, të nenit E, të Kushtetutës.

ta thërriste shtetasin S. B. si të paditur, pasi këtë të drejtë procedurale e ka pala paditëse dhe se nuk i është bërë një kërkesë e tillë. Po ashtu, ka parashtruar se nuk ka çmuar ta thërrasë si palë të tretë në gjykim dhe se mosmarrëveshja lidhet me shqyrtimin e një akti të nxjerrë nga pala e paditur, institucion publik. Ndërsa, është shprehur edhe se vlerësimin e kanë bërë gjykatat më të larta. Subjekti ka depozituar vendimin përkatës.

Vlerësimi i Komisionit

- Trupi gjykues, në analizë të konstatimit në rezultatet e hetimit dhe të prapësimeve të subjektit, çmon se nuk vërehen problematika në këtë rast, për shkak se subjekti ka argumentuar arsyen e mospjesëmarrjes së denoncuesit në procesin gjyqësor, si ndërhyrës apo si palë ndërgjyqëse.

✓ Lidhur me vlerësimin profesional

Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë⁴⁶: pikën 1, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “*vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit*”; nenin 59, të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “*vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues*”; nenin 44, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “*subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë...*”, arsyeton se mbi mangësitë e konstatuara në të teta dosjet mbi të cilët është vlerësuar kriteri profesional i subjektit të rivlerësimit, për sa kohë konstatohen çështje si ajo e vitit 2016 (dosja 5) ku subjekti ka zbatuar procedurën gjyqësore të parashikuar në ligjin nr. 49/2012, i ndryshuar, tregues ky që konfirmon ndërmarrjen e veprimeve të duhura krahasuar me çështjet e mëparshme, por edhe ato të konstatuara në denoncimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, të referuara sa më sipër, nuk janë të mjaftueshme për ta vlerësuar me mangësi profesionale.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Lidhur me kontrollin e figurës, trupi gjykues çmon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se:

- Për pasurinë e identifikuar me nr. 1/ apartament me sip. 111 m², subjekti ka mungesë financiare në shumën 1.546.623 lekë për të blerë këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare; ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën “Vetting” se për blerjen e kësaj pasurie burim krijimi është kredia në shumën 20.000 euro; ka kryer deklarin të pamjaftueshëm për shkak të mospërputhjeve të rezultuara midis deklarimit të subjektit në deklaratën “Vetting” se burim i krijimit të kësaj pasurie ishte kredia në shumën 20.000 euro dhe pagesave të kryera përpara disbursimit të saj në shumën 9.110 USD ose rreth 8.000 euro dhe pas disbursimit të kredisë në shumën 14.890 USD, ose rreth 13.000 euro; ka kryer deklarin të pasaktë se kredia në shumën 20.000 euro ka pasur destinacion njërin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe, për pasojë, në tërësi për këtë pasuri, ka bërë deklarin të pamjaftueshëm, referuar pikës 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- Për pasurinë e identifikuar me nr. 2, automjet tip “Ford Fiesta”, subjekti ka mungesë financiare në shumën 429.341 lekë për blerjen e saj dhe, për pasojë, ka bërë deklarin të

⁴⁶ Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”.

pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për krijimin e saj, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- Për pasurinë e identifikuar me nr. 3, apartament me sip. 110.9 m² + garazh, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për krijimin e saj, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- Për çështjen e identifikuar me nr. 12, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me shumën e shpenzuar për arredimin e pasurisë së ndodhur në qytetin e Beratit, referuar pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- Për çështjen e identifikuar me nr. 13, lidhur me analizën financiare të kryer ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka mungesë financiare në shumën 314.272 lekë në vitin 2005 dhe në shumën 82.051 lekë në vitin 2012, për të përballuar shpenzimet familjare.

Lidhur me kontrollin profesional, trupi gjykues krijoi bindjen se mangësitë profesionale të konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1/c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, mbështetur në pikën 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

Nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, mbështetur në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 4, germës “c” të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjana Velçani, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.12.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Firdes Shuli

Kryesues

Roland Ilia

Anëtar

Brunilda Bekteshi

Relator

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta